



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/156  
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Gjykatën Administrative dhe të Punës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

KONCEPT DOKUMENT  
PËR  
GJYKATËN ADMINISTRATIVE DHE TË PUNËS

Gusht 2023

Përmbajtja	
Përmbledhje e koncept dokumentit.....	4
Hyrje .....	5
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit .....	6
1.1. Hyrje .....	6
1.2. Efikasiteti në konfliktet administrative .....	8
1.3. Efikasiteti në kontestet e punës.....	12
1.4. Raporti i SIGMA për Kosovë i vitit 2021 .....	13
1.5. Projektligji për Konfliktet Administrative .....	13
1.6. Lista e dokumenteve të politikave dhe ligjeve në fuqi.....	17
1.7. Pema e problemit.....	22
1.7.1. Shkaqet .....	22
1.7.1.1. Kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme .....	22
1.7.1.2. Mungesa e prioritizimit të drejtësisë administrative dhe kontesteve të punës .....	23
1.7.1.3. Fragmentimi i praktikës gjyqësore dhe mungesa e specializimit .....	24
1.7.1.4. Shkaqet tjera lidhur me organet e administratës publike dhe cilësinë e përfaqësimit..	25
1.7.2. Efektet.....	26
1.7.2.1. Mosrealizimi i të drejtave në kohë të arsyeshme.....	26
1.7.2.2. Humbja e besimit të publikut dhe qasja e kufizuar në drejtësi.....	27
1.7.2.3. Mbikëqyrja e mangët e organeve të administratës publike nga gjyqësori.....	28
1.7.3. Palët e interesuara .....	28
1.8. Analiza krahasuese.....	29
1.8.1. Austria .....	29
1.8.2. Kroacia.....	34
1.8.3. Sllovenia.....	36
1.8.4. Maqedonia e Veriut.....	38
1.8.5. Shqipëria.....	42
Kapitulli 2: Objektivat .....	45
Kapitulli 3: Opsionet .....	46
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim .....	46
Kapitulli 3.2: Opsioni për fuqizimin e kapaciteteve pa ndryshime organizative .....	46
Kapitulli 3.3: Opsioni për ndryshime organizative ligjore .....	47
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme .....	52

Kapitulli 4.1. Ndikimet shoqërore.....	53
4.1.1. Ndikimet në të drejtat e punëtorëve .....	53
4.1.2. Ndikimet në informimin më të mirë të publikut.....	54
Kapitulli 4.2. Ndikimet në drejtat themelore .....	54
4.2.1. Mbikëqyrja gjyqësore e administratës publike.....	54
4.2.2. Qasja në drejtësi.....	54
Kapitulli 4.3. Ndikimet buxhetore.....	55
Kapitulli 4.4: Sfidat me mbledhjen e të dhënave .....	55
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi .....	55
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve.....	56
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme.....	57
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet.....	66
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm .....	68
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin .....	74
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik .....	75
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore .....	78
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore.....	81
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore.....	84

## Përmbledhje e koncept dokumentit

<b>Informacionet e përgjithshme</b>	
Titulli	KONCEPT DOKUMENTI PËR GJYKATËN ADMINISTRATIVE DHE TË PUNËS
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
Personi kontaktues	Selvije Elezaj-Brahimaj, Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë
Plani Strategjik operacional	Aktiviteti 2.1.8
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, Plani Strategjik Operacional - "Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative".

<b>Vendimi</b>	
Çështja kryesore	Efikasiteti i ulët në kontestet administrative dhe të punës
Përmbledhje e konsultimeve	Konsultimi paraprak është zhvilluar nga data 20 prill, deri me 15 maj 2023. Në këtë fazë janë pranuar komente nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë. Konsultimi publik është zhvilluar nga data 16 maj, deri me 5 qershor 2023. Në këtë fazë janë pranuar komente nga: Zyra e BE-së në Kosovë, OSBE, USAID – Programi për Drejtësi Komerciale, IKD.
Opsioni i propozuar	Themelimi i Gjykatës së re Administrative dhe divizioneve të veçanta për kontestet e punës nga sektori privat në kuadër të departamenteve të përgjithshme të gjykatave

<b>Ndikimet kryesore të pritshme</b>	
Ndikimet buxhetore	Opsioni i rekomanduar ka kosto shtesë, që është vlerësuar sipas VNB-së të përgatitur nga Ministria e Drejtësisë.
Ndikimet ekonomike	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet shoqërore	Ndikime në të drejtat e punëtorëve dhe informimin më të mirë të publikut
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet ndër-sektorale	Ndikime në të drejtat themelore të njeriut
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Testi i NVM-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta

<b>Hapat e ardhshëm</b>	
Afatskurtër	Ligji i ri për Gjykatën Administrative dhe ndryshimi i aktit nënligjor të KGJK-së.

Afatmesëm	Transferimi dhe rekrutimi i gjyqtarëve, dhe programet e specializuara të trajnimit për gjyqtarë dhe profesionistë të tjerë
-----------	--

## Hyrje

Figura 1 - Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	KONCEPT DOKUMENTI PËR GJYKATËN ADMINISTRATIVE DHE TË PUNËS
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
Personi kontaktues	Selviqe Elezaj-Brahimaj, Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë
PKZH	Plani Kombëtar Zhvillimor, qëllimi strategjik 9.1. Drejtësi efektive, nën-qëllimi strategjik 9.1.1. Drejtësi me kohë.
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, Plani Strategjik Operacional - "Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative".
Grupi punues	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Selviqe Elezaj-Brahimaj, Kryesuese</li> <li>2. Ardian Mehmeti, Zëvendës-kryesues</li> <li>3. Florent Spahija, Këshilltar i jashtëm politik i Ministres</li> <li>4. Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme</li> <li>5. Albert Zogaj, Kryesues i KGJK-së</li> <li>6. Arjeta Sadiku, Anëtare e KGJK-së</li> <li>7. Hajriz Hoti, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit</li> <li>8. Delushe Halimi, Gjyqtare në Gjykatën e Apelit</li> <li>9. Florentina Beqiraj, Koordinatore e Njesisë për të Drejtat e Njeriut</li> <li>10. Shqipe Cakolli Rraci, zv. Udhëheqëse e Divizionit për buxhet dhe financa</li> <li>11. Saranda Salihu, zv. Udhëheqëse e Zyrës për komunikim me publikun</li> <li>12. Albert Selimi, Zyrtar i lartë për koordinim të politikave</li> <li>13. Vjosa Hoxha, Zyrtare e lartë për koordinim të politikave, SKQ/ZKM</li> <li>14. Kushtrim Canolli, Zyrtar i lartë për planifikim të politikave, ZPS/ZKM</li> <li>15. Alberita Hyseni, Zyrtare e lartë ligjore ZL/ZKM</li> <li>16. Gëzim Bislimi, Analist i lartë i buxhetit, MFPT</li> <li>17. Gzim Shala, IKD</li> <li>18. Vyryte Gërvalla, BIRN</li> </ol>

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

### 1.1. Hyrje

Çdo person në Republikën e Kosovës ka të drejtë që çështja e tij ose saj të trajtohet në mënyrë të pavarur, të drejtë dhe brenda afatit të caktuar nga organet e administratës publike. Kjo e drejtë përcaktohet me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative<sup>1</sup> dhe ligjet tjera të veçanta që rregullojnë procedura administrative. Në mënyrë që administrata publike t'i shërbej qytetarët dhe bizneset në mënyrë efektive, duhet të ketë linja racionale dhe të qarta të llogaridhënies, qoftë nga Kuvendi, mekanizmat e pavarur mbikëqyrës apo edhe gjyqësori. Çdo shkelje e të drejtës në administrim të mirë, duhet t'i mundësoj personit që këtë të drejtë ta realizoj përmes gjykatës dhe të pranoj kompensimin e arsyeshëm.

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, drejtësia administrative është përcjellur me disa ndryshime në kuptim të legjislacionit për trajtimin e konflikteve administrative dhe organizimit të gjykatave që trajtojnë konfliktet administrative.

Deri në vitin 2010, konfliktet administrative kanë qenë kompetencë ekskluzive e Gjykatës Supreme. Nga viti 2010, me Ligjin për Gjykata<sup>2</sup>, kjo kompetencë i ka kaluar Gjykatës Themelore të Prishtinës ku është krijuar Departamenti për Çështje Administrative (DÇA), me kompetencë të gjykimit dhe vendosjes në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.<sup>3</sup> Ligji për Gjykata ka ndryshuar në vitin 2018<sup>4</sup> por kompetenca ekskluzive e Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes DÇA ka mbetur.<sup>5</sup> E vetmja risi që Ligji i vitit 2018 ka sjellur, ka qenë themelimi i Divizionit Fiskal në kuadër të Departamentit të lartpërmendur, për të gjykuar dhe vendosur në lidhje me paditë e ushtruara kundër akteve përfundimtare administrative për çështjet doganore dhe tatimore, të tatimit mbi pronën e paluajtshme dhe çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Republikën e Kosovës.<sup>6</sup> Gjykata e Apelit vepron si gjykatë e shkallës së dytë sipas këtij Ligji<sup>7</sup>, në kuadër të së cilës funksionon Departamenti për Çështje Administrative<sup>8</sup>. Ndërsa Gjykata Supreme shërben si instanca më e lartë gjyqësore për të vendosur sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.<sup>9</sup>

Në vitin 2022 është miratuar Ligji për Gjykatën Komerciale<sup>10</sup> me kompetencë, ndër të tjera, edhe në gjykimin dhe vendosjen për konfliktet administrative<sup>11</sup> sa i përket:

<sup>1</sup> Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 20 / 21 QERSHOR 2016, PRISHTINË. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

<sup>2</sup> Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat. GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 79 / 24 GUSHT 2010. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302>

<sup>3</sup> Po aty. Neni 14.

<sup>4</sup> Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat. GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 22 / 18 DHJETOR 2018, PRISHTINË. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302>

<sup>5</sup> Po aty. Neni 12.4 dhe Neni 17.

<sup>6</sup> Po aty. Neni 17.3.

<sup>7</sup> Po aty. Neni 21.

<sup>8</sup> Po aty. Neni 24.1.5.

<sup>9</sup> Po aty. Neni 25 dhe 26.

<sup>10</sup> Ligji nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale. GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 7 / 10 SHKURT 2022, PRISHTINË. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53748>

<sup>11</sup> Po aty. Neni 4.

- konflikteve të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore<sup>12</sup>, të cilat do të trajtohen nga Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale<sup>13</sup>, dhe
- konflikteve administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative<sup>14</sup>, të cilat do të trajtohen nga Departamenti për çështje Administrative i Gjykatës Komerciale<sup>15</sup>.

Sipas strukturës organizative, Gjykata Komerciale do të gjykoj në dhomat e shkallës së parë dhe në dhomat e shkallës së dytë. Vendimet e shkallës së parë janë të barasvlershme me vendimet e Gjykatës Themelore, kurse vendimet e dhomës së dytë janë të barasvlershme me vendimet e Gjykatës së Apelit.<sup>16</sup> Gjykata Supreme do të vazhdoj të trajtoj revizionin si mjet të jashtëzakonshëm juridik, por ato kundër vendimeve të Gjykatës Komerciale vetëm nëse vlera e kontestit është jo më pak se 30.000 € (euro).<sup>17</sup> Gjykata Komerciale është funksionalizuar me 1 gusht 2022 dhe është në proces të krijimit të kapaciteteve të plota të brendshme. Në këtë Gjykatë nga Gjykatat tjera janë bartur rreth 9 000 lëndë, prej të cilave më shumë se 2 000 lëndë konflikteve administrative janë bartur nga Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerciale, ndërsa një numër i konsiderueshëm i lëndëve janë bartur nga Departamenti Administrativ i Gjykatës së Apelit në dhomat e shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale.<sup>18</sup>

Në anën tjetër, kontestet nga marrëdhënia e punës trajtohen nga departamente të ndryshme qoftë sa i përket kompetencës lëndore në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, apo edhe kompetencës territoriale në kuadër të shtatë gjykatave themelore në Kosovë. Kontestet nga marrëdhënia e punës ku si palë e paditur është institucioni publik, aktualisht trajtohen nga departamente të ndryshme, varësisht nga regjimi juridik i aplikueshëm për punësimin/statusi i të punësuarit në institucion publik. Kështu, për shembull nëse statusi i të punësuarit është nëpunës civil sipas Ligjit për Zyrarët Publik<sup>19</sup> atëherë kontesti i punës trajtohet nga Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë, kurse në rast se statusi i të punësuarit është nëpunës i shërbimit publik sipas atij Ligji, për shembull zyrtar policor, doganor, ose ka statusin e nëpunësit administrativ dhe mbështetës, atëherë kontesti trajtohet në kuadër të divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme të gjykatave themelore në 7 rajonet e Kosovës.<sup>20</sup> Në anën tjetër, të gjitha kontestet në të cilat si palë e paditur paraqitet punëdhënësit privat trajtohen nga divizionet civile në kuadër të departamenteve të përgjithshme të shtatë gjykatave themelore në rajonet e Kosovës. Kompetenca territoriale në këto raste pra përcaktohet nga selia e punëdhënësit, apo sipas

<sup>12</sup> Po aty. Neni 13.1.11

<sup>13</sup> Po aty. Neni 13.4

<sup>14</sup> Po aty. Neni 13.1.12

<sup>15</sup> Po aty. Neni 13.5

<sup>16</sup> Po aty. Neni 10.1.

<sup>17</sup> Po aty. Neni 14.

<sup>18</sup> Shih Raportin vjetor Statistikor të Gjykatave, faqe 7. I qasshëm në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114\\_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf)

<sup>19</sup> Ligji nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik. Neni 2.1 dhe 32.1. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>

<sup>20</sup> Ibid. Neni 2.2 dhe 2.4, dhe Neni 64.1, 74.5 dhe 79.2. Kompetenca e divizioneve civile në kuadër të gjykatave themelore është e rregulluar me akte të brendshme të KGJK-së.




territorit në të cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht është dashur të kryhet, apo territori në të cilin është themeluar marrëdhënia e punës.<sup>21</sup>

Kjo ndarje reflektohet edhe në Gjykatën e Apelit, ku lëndët varësisht prej statusit të paditësit në rastet kur punëdhënësi është institucion publik, apo varësisht prej natyrës së palës së paditur – publik ose privat, zgjedhën qoftë nga Departamenti për Çështje Administrative apo Departamenti i Përgjithshëm.

## 1.2. Efikasiteti në konfliktet administrative

Të dhënat për efikasitetin e dy departamenteve në Gjykatën Themelore në Prishtinë, respektivisht Gjykatën e Apelit, sipas raportit 'Dashboard'<sup>22</sup> dhe raporteve statistikore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) ndër vite, paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Figura 2 - Koha në dispozicion në konfliktet administrative në DÇA të GJTHP dhe DÇA të GJA (burimi: Raporti 'Dashboard')



<sup>21</sup> Neni 49 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2583>

<sup>22</sup> CEPEJ. HFII: Towards a better evaluation of the results of judicial reform efforts in the Western Balkans "DASHBOARD Western Balkans" Data collection: 2021. Part 2 (A) - Beneficiary fiche – Kosova. Faqe 14. I qasshëm në: <https://rm.coe.int/kosovo-20220630-deliverable-2/1680a8c31d>

Figura 3 - Shkalla e spastrimit në konfliktet administrative në DÇA të GJTHP dhe DÇA të GJA (burimi: Raporti 'Dashboard')




Figura 4 - Konfliktet administrative, lëndët e pranuar dhe të mbetura në DÇA të GJTHP (Burimi: Raportet statistikore të KGJK-së)





Figura 5 - Konfliktet administrative, lëndët e pranuara dhe të mbetura në DÇA të GJA (Burimi: Raportet statistikore të KGJK-së)




Sa i përket normës së zgjedhjes së lëndëve, vlen të theksohet se në DÇA të GJTHP, gjatë vitit 2021 – 12 gjyqtarë kanë zgjedhur mesatarisht 20.49 lëndë secili<sup>23</sup>, ndërsa gjatë vitit 2022 – 8 gjyqtarë kanë zgjedhur mesatarisht 25.7 lëndë.<sup>24</sup>

<sup>23</sup> Raporti statistikor nga KGJK i vitit 2021. Faqe 9.

<sup>24</sup> Raporti statistikor nga KGJK i vitit 2022. Faqe 10.

Figura 6 - Llojet e konflikteve administrative (Burimi: të dhënat nga DÇA/GJTHP)<sup>25</sup>



<sup>25</sup> Këto të dhëna janë një mesatare e nxjerrur nga listat e brendshme të gjyqtarëve të DÇA në GJTHP ku evidentohen llojet e rasteve. Të dhënat janë plotësuar tutje në bazë të intervistave me këta gjyqtarë.

### 1.3. Efikasiteti në kontestet e punës

Sa i përket kontesteve nga marrëdhënia e punës, nga të dhënat e publikuara nga KGJK, ka qenë e pamundur të sigurohen të dhëna specifike për numrin e kontesteve të punës që janë aktualisht duke u trajtuar në gjykatat e Kosovës. Mirëpo, në bazë të diskutimeve në grup punues dhe intervistave specifike me gjyqtarët që trajtojnë konteste të tilla, si dhe raporteve të OJQ-ve të ndryshme, përceptimi është që numër më i madh i kontesteve gjyqësore të punës janë ato ku si palë e paditur është institucioni publik, kurse dukshëm më pak ato në të cilat palë e paditur është sektori privat. Rritjes së numrit të kontesteve të punës me institucionet publike i kanë kontribuar kontestet nga mos-zbatueshmëria e kontratave kolektive të lidhura në mes të Qeverisë dhe sektorëve të caktuar.<sup>26</sup> Gjithashtu, nëse shihet numri i ankesave në Inspektoratin e Punës, dominojnë ankesat nga sektori publik.<sup>27</sup>

Nga këto të dhëna, vërehet se pavarësisht ekzistimit të problemeve si punësimi joformal apo shkelja e të drejtave punëtorëve (rastet e punës jashtë orarit, mungesa e pushimeve, puna e rrezikshme, ndërprerja e marrëdhënies së punës, etj), punëtorët nga sektori privat nuk përdorin mjaftueshëm mekanizmat si Inspektorati i Punës apo nuk fillojnë konteste gjyqësore për të kërkuar të drejtat e tyre. Kjo mund të jetë për arsye të ndryshme si:

- mungesa e përgjithshme e besimit në sistem;
- mungesa e njohurive specifike për ekzistimin e mekanizmave shtetëror apo procedurave gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre;
- efikasiteti i ulët i gjykatave, të cilave ju duhen vite për të trajtuar kontestet.

Këto sfida mund të bëjnë që në vend të ushtrimit të ankesave dhe padive, veçanërisht punëtorët e sektorit privat të pajtohen me trajtimin jo të duhur nga punëdhënësi, apo çdo mos-marrëveshje ta zgjedhin drejtpërdrejtë me punëdhënësin, pavarësisht nëse përmes këtyre marrëveshjeve mund të realizojnë të drejtat e tyre apo jo.

Rastet e kontesteve të punës sipas ligjit duhet të trajtohen me prioritet<sup>28</sup>, mirëpo në praktikë ato zgjasin, për shembull në Gjykatën Themelore në Prishtinë është vërejtur se atyre ju duhen mesatarisht rreth më shumë se 3 vite për t'u përfunduar në shkallë të parë, ndërsa rreth 4-5 vite në të gjitha shkallët. Specifikisht, bazuar në të dhënat e vitit 2021, koha në dispozicion për rastet civile në shkallën e parë ka qenë 1,339 ditë dhe në shkallën e dytë 646 ditë.<sup>29</sup> Kjo për shkak të ngarkesës së madhe me lëndë dhe poashtu prioritizimit edhe të çështjeve tjera sipas ligjit. Efikasiteti është më i lartë në gjykatat tjera sa i

<sup>26</sup> Shih 'Mosbatimi i Kontratës Kolektive çon në dyfishim të lëndëve në divizionin civil' 24 shtator 2022, KOHA. Artikulli i qasshëm në: <https://www.koha.net/betimi-per-drejtasi-ktv/345174/mosbatimi-i-kontrates-kolektive-con-ne-dyfishim-te-lendeve-ne-divizionin-civil/>

<sup>27</sup> Shih Raportin vjetor të Inspektoratit të Punës 2021. Inspektimet sipas ankesës: 799 në sektorin privat dhe 4 353 në sektorin publik. Figura 6. Faqe 18, i qasshëm në: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf> apo BIRN dhe ATRC, Raporti 2022 "Trajtimi i rasteve të të drejtave të punëtorëve nga Inspektorati i Punës dhe Gjyqësorit" ku evidentohet se gjatë vitit 2020 dhe 2021 janë paraqitur shumëfish më shumë ankesa nga sektori publik në krahasim me sektorin privat (2020 – 9 801 nga sektori publik dhe vetëm 646 nga sektori privat; 2021 – 4 353 nga sektori publik dhe vetëm 799 nga sektori privat). Raporti është i qasshëm në: [https://kallxo.com/wp-content/uploads/2023/01/Raporti\\_ALB-BIRN-Kosovo-1-min.pdf](https://kallxo.com/wp-content/uploads/2023/01/Raporti_ALB-BIRN-Kosovo-1-min.pdf)

<sup>28</sup> Neni 475 i Ligjit për Procedurë Kontestimore

<sup>29</sup> Raporti i 'DASHBOARD' Faqe 14.

përket kontesteve të punës, përveç Gjykatës Themelore në Mitrovicë.<sup>30</sup> Në përgjithësi, përveç Gjykatës Themelore të Prishtinës, asaj të Gjilanit dhe të Pejës, gjykatat tjera kanë pranuar dukshëm më pak padi lidhur me kontestet e punës.<sup>31</sup> Në bazë të këtij Raporti rezulton se rreth 7519 konteste të punës në divizionet civile të gjykatave themelore kanë qenë të pazgjidhura në fund të vitit 2021. Pa dyshim se lëndët nga mos-zbatimi i kontratave kolektive e kanë rritur këtë numër. Sa i përket efikasitetit, gjithashtu, një raport tjetër evidenton se në periudhën 2016-2018 nga 11 834 lëndë në punë vetëm 4 215 prej tyre janë gjykuar, apo 35.6%.<sup>32</sup>

Vlen gjithashtu të theksohet se në përgjithësi në rastet kontestimore gjatë vitit 2021, mesatarja e gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për muaj ka qenë 17.89 lëndë të zgjidhura në muaj për një gjyqtar<sup>33</sup>, ndërsa në vitin 2022 – 20 lëndë për një gjyqtar.<sup>34</sup>

#### 1.4. Raporti i SIGMA për Kosovë i vitit 2021

Sipas Raportit të SIGMA për Kosovën i vitit 2021, gjejmë Parimit 4 – ‘trajtimi i drejtë i konflikteve administrative garantohet nga ankesat e brendshme administrative dhe rishikimi gjyqësor’, Kosova shënon notën 3 që është e njëjtë me vitin 2017.

Aty theksohet që drejtësia administrative në Kosovë pengohet nga kapacitetet jo të mjaftueshme. Mesatarisht, një procedurë gjyqësore administrative zgjat më shumë se tre vite dhe SMIL, publikimi i aktgjykimeve dhe masat tjera janë zhvillime pozitive por nuk munden të vetme të zgjedhin numrin e madh të lëndëve të grumbulluara.

Sipas Raportit, pasi që nuk ka gjykatë të veçantë administrative, konfliktet administrative vendosen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku specializimi i plotë i gjyqtarëve nuk sigurohet pasi që ata trajtojnë konflikte lidhur me kundërvajtjet në paralel me rastet administrative. Gjyqtarët mbështeten nga një numër i pamjaftueshëm i asistentëve ligjorë (10 asistentë për 12 gjyqtarë) dhe kanë qasje në trajnimet e Akademisë së Drejtësisë, bazuar në një mekanizëm gjithëpërfshirës për vlerësimin e nevojave të trajnimit.

Kohën në dispozicion në instancë të parë për përfundimin e lëndës administrative sipas metodologjisë së CEPEJ, që në Kosovë për vitin 2020 ka qenë 1188 ditë e krahason me mesataren rajonale të vitit 2020 që është 544 ditë dhe mesataren e vendeve të Këshillit të Evropës të vitit 2018 – 248 ditë.<sup>35</sup>

#### 1.5. Projektligji për Konfliktet Administrative

Në anën tjetër, procedura e konflikteve administrative është gjithashtu në reformim e sipër. Ministria e Drejtësisë me përkrahje të SIGMA/OECD ka përgatitur Projektligjin për Konfliktet Administrative i cili është aktualisht në procedurë të leximit të dytë në Kuvendin e Kosovës.

<sup>30</sup> OJQ Lens. Draft Raport ‘(Mos) Trajtimi i kontesteve të punës’ 2022, faqe 19-29

<sup>31</sup> Ibid, faqe 32.

<sup>32</sup> BIRN dhe ATRC, Raporti 2022 "Trajtimi i rasteve të drejtave të punëtorëve nga Inspektorati i Punës dhe Gjyqësorit faqe 24.

<sup>33</sup> Raporti statistikor i KGJK-së për vitin 2021. Faqe 9.

<sup>34</sup> Raporti statistikor i KGJK-së për vitin 2022. Faqe 10.

<sup>35</sup> SIGMA Monitoring Report ‘The Principles of Public Administration’. Kosovo 2021. Faqe 104-106. I qashtëm në: <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Kosovo.pdf>

Ky Projektligj, para se gjithash, synon të arrij: 1) mbrojtje të plotë juridike gjyqësore ndaj gjitha formave të veprimtarisë të administratës publike; 2) proces gjyqësor efektiv dhe brenda një kohe të arsyeshme; 3) rol më pro-aktiv të gjykatës, dhe 4) rritje të efikasitetit të sistemit gjyqësor në trajtimin e konflikteve administrative.

Fillimisht, duke parë nevojë për rregullimin më specifik të procedurës së gjykimit të konflikteve administrative, Projektligji paraqet dispozita shumë më të avancuara dhe detajuara në raport me Ligjin në fuqi të vitit 2010 për Konfliktet Administrative, i cili për shumë çështje procedurale i referohet legjislacionit për procedurën civile në fuqi, që ka shkaktuar vështirësi në zbatim si për gjyqtarët, ashtu edhe për palët dhe akterët tjerë të përfshirë në procedurë.

Pastaj, Projektligji ka detajuar llojet e padive që mund të paraqiten për të iniciuar një konflikt administrativ, gjithsej tetë (8): padia e anulimit; padia për nxjerrjen e një akti administrativ; padia ndaj veprimit tjetër administrativ; padia deklarative; padia e dëmit; padia ndaj aktit nënligjor normativ; padia e kompetencës; dhe padia lidhur me kontratën administrative. Projektligji parasheh rregulla për veprimet përgatitore që duhet të ndërmerren nga gjykata, si dhe i ofron tutje dy mundësi të zhvillimit të procedurës: në seancë gjyqësore kryesore ku ftohen palët, apo në seancë të trupit gjykues me procedurën me shkrim, pra pa prezencën e palëve. Mundësia e dytë është një risi e këtij Projektligji, e cila ofrohet për të siguruar efikasitet, por kjo mund të bëhet vetëm në rastet kur palët japin shprehimisht pëlqimin për këto, apo Gjykata vlerëson se faktet në bazë të çështjes janë përcaktuar dhe shqyrtimi nuk është kompleks në çështjet faktike dhe ligjore. Edhe në këto raste, Gjykata edhe pse vendos kështu, mund në ndërkohë gjatë zhvillimit të procedurës të vendosë që çështje të caktuara faktike të diskutohen megjithatë në një seancë gjyqësore.

Duke synuar efikasitetin e procedurës, Projektligji thekson poashtu se të gjitha procedurat duhet të regjistrohen në SMIL dhe hap rrugën për një komunikim elektronik mes gjykatës dhe palëve në procedurë, por edhe mbajtjen e seancave me komunikim në distancë

Për më shumë, Projektligji ka qartësuar detyrimin dhe afatin për paraqitjen e dosjes së rastit në konflikt, nga pala e paditur, në kërcënim të gjobës, por edhe afatin për përgjigje në padi. Ky detyrim shtrihet edhe tek çdo organ tjetër publik, sipas përcaktimit të Gjykatës, të paraqesë, dokumente, dosje, përfshirë dokumente elektronike dhe të jap informacionin e kërkuar nga Gjykata, edhe kjo në kërcënim të gjobës. Vlen të theksohet se mundësia që Gjykata të paraqes gjoba ndaj zyrtarit kryesor administrativ të institucionit publik, por edhe ndaj zyrtarëve tjerë përgjegjës për çështje tjera, është risi e këtij Projektligji.

Rregullat e përcaktuara për seancën kryesore sipas Projektligjit janë specifike për natyrën e konflikteve administrative, ku vlen të përmendet se gjykata shqyrton dhe vendos për çështjen brenda kufijve të objektit të padisë, por nuk kufizohet në arsyetimet dhe faktet e paraqitura. Gjykata e ka për obligim të qartësoj të gjitha faktet e nevojshme për të marrë një vendim të drejtë.

Ajo çka është tejet e rëndësishme nga ky Projektligj është se të gjitha vendimet e Gjykatës duhet të jenë në meritë, pra nuk mund të kthehen lëndët në rishqyrtim apo rivendosje në administratën publike. Kjo

është një ndryshim substancial nga Ligji i vitit 2010 cili e ka mundësuar kthimin e lëndës tek administrata publike (e cila në raste të caktuara përsëri e ka marr vendimin e njejtë) dhe ka krijuar efektin 'ping-pong'<sup>36</sup>.

Pastaj sa i përket mjeteve juridike, vlen të përmendet se me këtë Projektligj ekzistojnë vetëm dy nivele të gjykimit, dhe Gjykata Supreme shërben vetëm për të gjykuar revizionet apo paditë ndaj akteve nënligjore (në atë rast vepron si gjykatë e shkallës së parë dhe e vetme). Poashtu, janë përcaktuar rregulla që gjykata e shkallës e dytë kur të vendos për ankesën, duhet të vendos përfundimisht për lëndën dhe nuk ka të drejtë të kthej në rishqyrtim përsëri lëndën në Gjykatën e shkallës së parë. Ky ndalim dhe eliminimi i efektit 'ping-pong' të përmendur më lartë në mes të gjyqësorit dhe administratës do të ketë një ndikim të jashtëzakonshëm në efikasitetin e procedurës, që siguron mbrojtjen e të drejtave të palëve, por edhe eliminimin e 'backlog' aktual të konflikteve administrative.

Sa i përket masave të sigurisë, Projektligji ka detajuar se kur mund të vendoset për to dhe ka vendosur detyrimin për Gjykatën që të rishqyrtoj kushtet për marrjen e masës, pra nëse ato ende vazhdojnë të plotësohen, për të evituar situata kur masa e sigurisë merret me rastin e paraqitjes së padisë dhe pastaj lënda nuk zgjidhet për disa vite, e ndërkohë masa e sigurisë e humb kuptimin e saj. Gjithashtu, në Projektligj është theksuar se lëndët për të cilat caktohet masa e sigurisë trajtohen me prioritet nga Gjykata.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore të konfliktit administrativ barten nga pala që e humb procesin gjyqësor. Kështu parashihet në Projektligjin e propozuar dhe kjo e përmirëson një anomali që Ligji i vitit 2010 aktualisht e ka me të cilin theksohet se shpenzimet ndahen në mënyrë të barabartë nga palët.

Për dallim nga Ligji i vitit 2010 që ka mangësi serioze në dispozitat që rregullojnë përmbarimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke i bërë ato vështirë të zbatueshme në praktikë, Projektligji në këtë Kapitull në detaje ka rregulluar procedurën e përmbarimit të vendimeve gjyqësore. Ndër të tjera vlen të përmenden si risi mundësia për Gjykatën të vendos gjopa ndaj zyrtarëve përgjegjës dhe zyrtarëve kryesor administrativ të institucioneve publike për mos-ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, parashihet edhe mundësia që Gjykata të nxjerr drejtpërdrejtë aktin apo duke angazhuar Komisionerin e Jashtëzakonshëm nga radhët e ekspertëve, atëherë kur asnjë mënyrë tjetër e përmbarimit nuk është e suksesshme.

Lidhur me këtë Koncept Dokument, për sa i përket organizimit të sistemit gjyqësor apo gjykatës(ave) kompetente për gjykimin e konfliktit administrativ, si dhe kompetencës së tyre të veçantë, ky Projektligj parasheh se kjo rregullohet me ligje tjera të veçanta. Në këtë rast ligje në fuqi në Kosovë që e rregullojnë organizimin dhe kompetencën për gjykimin administrativ, janë Ligji për Gjykatat<sup>37</sup> dhe Ligji për Gjykatën Komerciale.<sup>38</sup>

---

<sup>36</sup> Bartja e rastit nga administrata tek Gjykata dhe anasjelltas, madje disa herë, duke i pamundësuar palës që rasti i tij apo saj të vendoset përfundimisht dhe sipas meritave

<sup>37</sup> Ligji nr. 06/l-054 për Gjykatat. 2018. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302>

<sup>38</sup> Ligji nr. 08/l-015 për Gjykatën Komerciale. 2022. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53748>



Siç u cek më lartë, Ligji për Gjykatat aktualisht rregullon Departamentin për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë (GJTHP) si organ kompetent për të trajtuar gjykimin e konflikteve administrative, në të cilat palë janë individët (personat fizik si paditës) në raport me administratën publike (si e paditur). Kurse, Ligji për Gjykatën Komerçiale e parcakton kompetencën e kësaj Gjykate për gjykimin e të gjitha konflikteve administrative në të cilat palë janë bizneset (si paditës) në raport me administratën publike (si e paditur).

1.6. Lista e dokumenteve të politikave dhe ligjeve në fuqi

Figura në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur kornizën ligjore në fuqi për konfliktet administrative dhe kontestet nga marrëdhënia e punës

Figura 7 - Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji për Gjykatat	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Gjykatat e Republikës së Kosovës	<p>Ky ligj në Nenin 14 përcakton Juridiksionin e DÇA në Gjykatën Themelore i cili gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.</p> <p>Neni 13 (1.5) përcakton kompetencat e departamenteve të përgjithshme në kuadër të gjykatave themelore dhe degëve të tyre. Divizionet civile pastaj përmes akteve të brendshme të KGJK-së janë të krijuara në kuadër të departamenteve të përgjithshme të shtatë gjykatave themelore.</p> <p>Gjithashtu, me të njëjtin Ligj - neni 20 parasheh ndarjen organizative të Gjykatës së Apelit dhe Departamentin për Çështje administrative brenda saj, i cili trajton çështjet e konfliktit administrativ si shkallë e dytë në bazë të ankesës (vendosja në kolegi gjyqtarësh).</p> <p>Ndërsa, nenet 21-22 përcaktojnë kompetencën e Gjykatës Supreme, sa i përket kërkesës për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës.</p>

Ligji për Gjykatën Komerçiale	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Gjykata Komerçiale Gjykata Supreme	Ky Ligj në nenin 4 përcakton se të gjitha kontestet tregtare dhe konfliktet administrative janë në kompetencë të Gjykatës Komerçiale.  Gjithashtu në Nenin 10 (paragrafi 2) përcaktohet se Dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerçiale përbëhen nga katër (4) departamente të ndara, përfshirë Departamentin për Çështje Ekonomike, Departamentin Fiskal, Departamentin për Çështje Administrative dhe Departamentin e Përgjithshëm.  Neni 13, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11, ndërflidhur me paragrafin 4, ka përcaktuar se kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore, trajtohen nga Departamenti Fiskal në kuadër të Gjykatës Komerçiale.  Gjithashtu, Neni 13, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12, ndërflidhur me paragrafin 5, ka përcaktuar se kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative, trajtohen nga DÇA në kuadër të kësaj Gjykate.
Ligji për Konfliktet Administrative	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë Gjykata Komerçiale Gjykata e Apelit	Neni 23 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton se për paditë kundër akteve administrative të administratës vendos gjykata kompetente për çështjet administrative në shkallë të parë, nëse me dispozita të tjera ligjore nuk është përcaktuar ndryshe. Ankesa ndaj vendimit të nxjerrë në konfliktin administrativ, trajtohet nga gjykata kompetente për çështje administrative e shkallës së dytë.

	<u>Kuvendi i Kosovës</u>	Gjykata Supreme Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë Gjykata Komerçiale Gjykata e Apelit Gjykata Supreme	Neni 10 (paragrafi 1) i Projektligjit përcakton se Organizimi i sistemit të gjykatës apo gjykatave kompetente për gjykimin e konfliktit administrativ, dhe juridiksioni apo kompetenca përkatëse rregullohet me ligj (të veçantë).  Kurse, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton se Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe zgjidh konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatave më të ulëta.
Projektligji për Konfliktet Administrative			
Ligji për Procedurën Kontestimore	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Gjykatat e Republikës së Kosovës	Me këtë Ligj caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.  Neni 475 i Ligjit përcakton se në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.
Ligji për Kundërvajtje	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Organet e Kundërvajtjes  Gjykatat	Organet e Kundërvajtjes zhvillojnë procedurën e kundërvajtjes në raste të caktuara dhe ndaj vendimeve të tyre mund të iniciohet konflikt administrativ në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.  Divizionet e kundërvajtjes trajtojnë kërkesat për fillimin e procedurës së kundërvajtjes dhe zhvillojnë tutje procedurën kundërvajtëse nëse këto kërkesa pranohen.

Ligji i Punës	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Gjykatat Inspektorati i Punës	<p>Neni 78 thekson të drejtën e të punësuarit që vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, të mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura, ndërsa punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës dhe të ja dorëzoj të punësuarit një vendim të tillë brenda afatit prej tetë (8) ditë.</p> <p>Neni 79 rregullon mbrojtjen gjyqësore, sipas të cilit çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.</p> <p>Neni 82 përcakton se i punësuar në çdo kohë mund t'ia dorëzojë ankesën Inspektoratit të Punës për çështje të cilat bien nën kompetencat e këtij organi. Në rast se Inspektorati gjen shkelje të ligjit të punës, në përputhje me Nenin 83 mund të ndëshkoj punëdhënësin.</p>
Ligji për Inspektoratin e Punës dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e tij	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Inspektorati i Punës	<p>Sipas këtij Ligji, Inspektorati i Punës mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në lëmin e punës në mënyrë gjithëpërfshirëse duke përfshinë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.</p> <p>Kundër vendimit të Inspektoratit të punës sipas Ligjit mund të ngritet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.</p>
Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	<u>Gazeta Zyrtare</u>	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë (KPMShC)	<p>KPMShC është institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.</p>

			<p>Ky Këshill ka kompetencat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;</li> <li>- mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislationit për shërbimin civil;</li> <li>- monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislationit për shërbimin civilë.</li> </ul> <p>Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ.</p>
--	--	--	--

## 1.7. Pema e problemit

Problemi kryesor i identifikuar nga grupi punues është efikasiteti i ulët në kontestet administrative dhe ato të punës, siç është dëshmuar përmes të dhënave në pjesën hyrëse të këtij Koncept Dokumenti. Ky problem vjen si rrjedhojë e shkaqeve të ndryshme si dhe prodhon efekte të caktuara qoftë në individët që ballafaqohen me këtë problem por edhe shoqërinë në përgjithësi. Figura në vijim paraqet pemën e problemit të krijuar për qëllime të këtij Koncept Dokumenti.

Figura 8 - Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

<b>Efektet</b>	Mosrealizimi i të drejtave në kohë të arsyeshme (drejtësia e vonuar)
	Humbja e besimit të publikut dhe qasja e kufizuar në drejtësi
	Mbikëqyrja e mangët nga gjyqësori
<b>Problemi kryesor</b>	<b>Efikasiteti i ulët në kontestet administrative dhe ato të punës</b>
<b>Shkaqet</b>	Kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme
	Mungesa e prioritizimit të drejtësisë administrative dhe kontesteve të punës
	Fragmentimi i praktikës gjyqësore dhe mungesa e specializimit
	Shkaqet tjera lidhur me organet e administratës publike dhe cilësinë e përfaqësimit

### 1.7.1. Shkaqet

#### 1.7.1.1. Kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme

DÇA i GJTHP aktualisht përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë dhe tre (3) bashkëpunëtorë profesional, ndërsa Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës së Apelit nga katër (4) gjyqtarë dhe një (1) bashkëpunëtorë profesional, si dhe në Gjykatën Supreme janë dy (2) gjyqtarë të cilët gjykojnë rastet e konflikteve administrative.

Pesëmbëdhjetë (15) gjyqtarë në të gjitha tre nivelet e gjykatave që gjykojnë kontestet administrative (pa llogaritur gjyqtarët e Gjykatës Komerciale) dhe katër (4) bashkëpunëtorë profesional, krahasuar me numrin e lëndëve që trajtohen nga Departamentet për Çështjet Administrative në Gjykatën Themelore dhe atë të Apelit, janë të pamjaftueshëm për të trajtuar të gjitha kontestet administrative. Gjithashtu, në Gjykatën Komerciale janë tre (3) gjyqtarë në kuadër të dy departamenteve që trajtojnë konteste administrative: Departamenti Fiskal dhe Departamenti për Çështje Administrative.

Mesatarja e zgjedhjes së lëndëve nga gjyqtarët në Departamentin për Çështje Administrative të GJTHP gjatë vitit 2021 ka qenë 20.49 lëndë për një gjyqtar në muaj<sup>39</sup> dhe në vitin 2022 – 25.7 lëndë për një gjyqtar në muaj<sup>40</sup>, ndërsa në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit – 24.36 lëndë

<sup>39</sup> KGJK - Raporti Statistikor i Gjykatave. 2021. Faqe 7. I qasshëm në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/91632\\_KGJK\\_Raporti\\_Statistikor\\_Vjetor\\_Gjykatave\\_2021.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/91632_KGJK_Raporti_Statistikor_Vjetor_Gjykatave_2021.pdf)

<sup>40</sup> KGJK - Raporti Statistikor i Gjykatave. 2022. Faqe 8. I qasshëm në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114\\_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf)

për një gjyqtar në muaj në vitin 2021<sup>41</sup> dhe 28.22 lëndë për një gjyqtar në muaj në vitin 2022<sup>42</sup>. Pavarësisht që kjo tregon një efikasitet mjaft të lartë nga këta gjyqtarë krahasuar me degët tjera, duhet marr parasysh që reforma me Projektligjin për Konflikte Administrative vlerësohet se do të rris numrin e konflikteve administrative në gjykatë. Kjo për faktin se me këtë Projektligj janë paraparë lloje të reja të padive, të cilat zgjerojnë gamën e mbrojtjes gjyqësore ndaj veprimeve të administratës publike, si dhe parasheh masa konkrete për të siguruar efikasitetin e procedurës gjyqësore të konflikteve administrative, që mund të ngritë besimin e publikut në gjyqësor dhe si rrjedhojë motivoj ata të fillojnë procedura gjyqësore. Gjithashtu, Projektligji parasheh vendosjen e detyrueshme sipas meritës të lëndëve që trajtohen, duke hequr mundësinë e kthimit në rishqyrtim të lëndës tek organi administrativ. Kjo nënkupton se gjyqtarëve administrativ do të ju duhet më shumë kohë për të gjykuar një konflikt administrativ.

Në anën tjetër, divizionet civile të departamenteve të përgjithshme në kuadër të gjykatave themelore, nuk kanë gjyqtar të caktuar që trajtojnë ekskluzivisht kontestet e punës. Pra, këto konteste trajtohen nga të gjithë gjyqtarët në kuadër të këtyre divizioneve, sipas shpërndarjes automatike të lëndëve. Këta gjyqtarë trajtojnë edhe konteste tjera civile dhe veçanërisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë të mbingarkuar.

Sa i përket zbatimit të Ligjit të Punës, vlen të theksohet se Qeveria e Kosovës rishtazi ka ndërmarr masa konkrete për rritjen e buxhetit dhe numrit të inspektorëve të punës<sup>43</sup>. Kjo pritet të ketë efekt në senzibilizimin e të punësuarve dhe në evidentimin më të madh, së paku në vitet e para, të shkeljes së të drejtave lidhur me punën, që mund të rezultoj gjithashtu në rritje të kontesteve gjyqësore të punës.

Përveç kapaciteteve njerëzore, në përgjithësi vlen të theksohet se nuk mbahen seanca *online*, apo madje as ftesat nuk dërgohen tek paditësit në mënyrë elektronike. Rishtazi ka filluar një pilot projekt për dërgimin e ftesave nga Gjykata Themelore e Prishtinës përmes e-mailit tek Avokatura Shtetërore si përfaqësuese e palës së paditur – institucionit publik, në konfliktet administrative.

1.7.1.2. Mungesa e prioritizimit të drejtësisë administrative dhe kontesteve të punës  
Efikasiteti i ulët rezulton edhe nga fakti se drejtësia civile në përgjithësi dhe penale konsiderohen në një masë më të prioritetizuar se sa drejtësia administrative që është jashtë fushëveprimit të Gjykatës Komerciale. Kjo për shkak të numrit të madh të rasteve të kontesteve civile të pazgjdhura, dhe vazhdimisht të reja të pranuar, si dhe përpjekjeve për të gjykuar lëndët penale në kohë dhe në këtë drejtim evituar parashkrimin e lëndëve penale. Si rrjedhojë edhe proceset e rekrutimit të gjyqtarëve të rinj të zhvilluara deri tani, dhe vendimeve të Kryetarëve të Gjykatave për caktimin e departamenteve ku gjyqtarët e rinj do të punojnë, prioritet kanë qenë departamentet për lëndët civile dhe ato penale. Mund të thuhet, se situatë e njëjtë është edhe me caktimin e bashkëpunëtorëve profesional ku prioritetizohet caktimi i tyre në departamentet tjera.

Gjatë vitit të fundit, prioritet pra ka qenë themelimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale që siç është shpjeguar më lartë do të trajtoj një numër të madh të kontesteve administrative aktuale në gjyqësor.

<sup>41</sup> KGJK - Raporti Statistikor i Gjykatave. 2021. Faqe 6.

<sup>42</sup> KGJK - Raporti Statistikor i Gjykatave. 2022. Faqe 6.

<sup>43</sup> Buxheti për Inspektorati i Punës është paraparë të jetë 1, 575, 632 ose 99% më i lartë se buxheti i vitit 2022 që ishte 790,632 euro. Numri i të punësuarve në këtë institucion është paraparë të rritet nga 90 (sa është aktualisht) në 190, me një rritje prej 111%. Burimi: Buxheti i Kosovës për vitin 2023. Faqe 35. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68589>



Deri më tani asnjë gjyqtar i departamenteve administrative nuk ka qenë anëtar i KGJK-së, ndërsa rishtazi një gjyqtare nga Departamenti Administrativ i GJTHP është emëruar në këtë pozitë, që mund të rris fokusin e KGJK-së në drejtësinë administrative.

Sa i përket kontesteve të punës, vlen të theksohet se për shkak të ngarkesave të lartpërmendura me rastet civile, kontestet e punës nuk trajtohen me prioritet siç kërkohet me ligj, dhe efikasiteti mbetet i ulët.<sup>44</sup>

#### 1.7.1.3. Fragmentimi i praktikës gjyqësore dhe mungesa e specializimit

Nga analizat e bëra, vërehet se praktika gjyqësore në drejtësinë administrative nuk është e unifikuar mjaftueshëm. Janë të rralla rastet, veçanërisht viteve të fundit, të mbajtjes së tryezave për të diskutuar kontestet administrative me të cilat ballafaqohen aktualisht gjyqtarët, qoftë në mes të gjyqtarëve në kuadër të DÇA të GJTHP, apo edhe në mes të tyre me gjykatat më të lartë – Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Kjo mund të arsyetohet me numrin e vogël të gjyqtarëve dhe ngarkesën e madhe me lëndë që aktualisht ballafaqohen.

Fragmentimi i kontesteve administrative ekziston edhe për faktin se me krijimin e Gjykatës Komerciale një pjesë e këtyre kontesteve trajtohen nga kjo Gjykatë. Specifikisht, kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare me autoritetet publike trajtohen nga Gjykata Komerciale, ndërsa kontestet tjera administrative, pra ato të iniciuara nga personat fizik ndaj autoriteteve publike trajtohen nga DÇA. Kjo pamundëson specializimin e gjyqtarëve në konteste administrative dhe e vështirëson unifikimin e praktikës gjyqësore.

Në fragmentimin e praktikës gjyqësore kontribuon edhe jo-konsistenca apo mos-harmonizimi i ligjeve materiale, si dhe paqartësitë që ekzistojnë në to. Këto ligje e bëjnë më të vështirë për gjyqtarët për të interpretuar këto ligje, veçanërisht në mënyrë të unifikuar, dhe si rrjedhojë ndikojnë edhe në efikasitet.

Për kontestet e punës më lartë u cek që nuk ka gjyqtar të caktuar ekskluzivisht për to, mirëpo edhe në kuadër të DÇA të GJTHP nuk ka specializim të gjyqtarëve sa i përket llojeve tjera të konflikteve administrative. Trajnime *ad-hoc* qoftë specifike apo të përgjithshme për drejtësinë administrative ofrohen nga Akademia e Drejtësisë, por ato nuk përcjellën me specializimin e mëtutjeshëm të gjyqtarëve, gjegjësisht për t'u caktuar që të punojnë në lloje të veçanta të konflikteve administrative. Tanimë, siç qëndron situata, të gjithë nëntë (9) gjyqtarët e DÇA në GJTHP gjykojnë pothuajse të gjitha llojet e konflikteve administrative.

Fragmentimit të mëtutjeshëm i kontribuon edhe fakti se në sistemin gjyqësor të Kosovës, rastet e kundërvajtjeve trajtohen nga departamente të ndryshme. DÇA në GJTHP trajton kontestet e personave fizik të iniciuara sipas padive të personave fizik ndaj kundërvajtjeve për të cilat është shqiptuar gjoba nga organi kundërvajtës (p.sh. Policia, Inspektorati) kur: (a) është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; (b) është paraparë sanksioni për personin fizik gjoba deri në 500 euro; dhe (c) është paraparë shqiptimi i gjobës në vend.<sup>45</sup> Këto raste dallojnë nga kundërvajtjet tjera në të cilat organi kundërvajtës ose personi i dëmtuar paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse në gjykatë dhe pastaj gjyqtari i kundërvajtjes zhvillon procedurën dhe vendos tutje për rastin. Këta gjyqtarë të kundërvajtjes nuk bëjnë

<sup>44</sup> Shih faqen 12 të Koncept Dokumentit, ku theksohet se një kontest i punës gjykohet mesatarisht për 2-3 vite në shkallë të parë, dhe 4-5 vite në të gjitha instancat gjyqësore.

<sup>45</sup> Shih Nenin 56 dhe Nenin 64 të Ligjit për Kundërvajtje që përcakton këtë kompetencë për Gjykatën që trajton konfliktin administrativ. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839>

pjesë në DÇA të GJTHP, por në divizionet e kundërvajtjes në departamentet e përgjithshme të shtatë (7) gjykatave themelore në Kosovë.

1.7.1.4. Shkaqet tjera lidhur me organet e administratës publike dhe cilësinë e përfaqësimit Në efikasitet të ulët në kontestet administrative dhe të punës kontribuojnë edhe shkaqe tjera:

- **Mangësitë dhe neglizhenca në zhvillimin e procedurave administrative nga organet e administratës publike** – Një numër i rëndësishëm i vendimeve jo të ligjshme dhe shkeljet e të drejtave të palëve gjatë këtyre procedurave, rezultojnë në rritjen e numrit të kontesteve të iniciuara në gjykatë. Pavarësisht vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, brenda organeve të administratës publike nuk ka një sistem të qëndrueshëm për të siguruar që ato mësojnë nga gabimet e bëra dhe nuk i përsërisin ato në procedurat administrative në të ardhmen. Rishtazi, janë disa zhvillime në kuptim të organizimit të tryezave të përbashkëta në mes të gjyqtarëve dhe organeve të specializuara të administratës publike për qartësimin e problemeve në këtë drejtim.

- **Njohuritë e avokatëve për drejtësinë administrative apo edhe interesimi i vogël i tyre për këto raste** - Ekziston një numër i vogël i avokatëve të specializuar në drejtësinë administrative dhe Oda e Avokatëve duket se i kushton më shumë rëndësi trajnimit të avokatëve në fushën penale dhe civile. Interesimi i vogël i avokatëve për kontestet administrative ku përfshihen personat fizik rezulton nga fakti se sipas Ligjit aktual për konfliktet administrative shpenzimet gjyqësore ndahen në pjesë të barabarta në mes të palëve ndërgjyqëse<sup>46</sup>, pavarësisht epilogut të kontestit. Kjo ndikon që edhe palët mos të angazhojnë avokat në kësi raste.

- **Cilësia e përfaqësimit nga Avokatura Shtetërore** - Deri në fillim të vitit 2023 Avokatura Shtetërore ka pasur një numër të vogël të avokatëve që përfaqësojnë institucionet publike në kontestet e ndryshme gjyqësore. Kjo ka krijuar vështirësi në menaxhimin e lëndëve nga ta, përgjigjeve dhe ofrimit të provave/dokumenteve me kohë, pastaj prezencën në seancat e çdo kontesti administrativ, dhe cilësinë në përgjithësi në përfaqësimin adekuat të institucionit publik si palë e paditur. Rishtazi, në kuadër të Avokaturës Shtetërore janë rekrutuar katër (4) avokatë shtesë, të cilët pritet të kenë ndikim pozitiv në këtë çështje.

- **Mangësitë e sistemit të ndihmës juridike falas** - Në përgjithësi, disa padi shpesh kthehen nga Gjykata tek palët për qartësim dhe plotësim të mëtutjeshëm. Poashtu, janë të shumta rastet kur pala (veçanërisht në kontestet lidhur me skemat sociale) paraqitet vetë në gjykatë pa avokat dhe kjo i merr më shumë kohë gjykatës për të informuar palën dhe siguruar mbrojtjen e të drejtave të tij ose saj. Gjithashtu ka raste ku disa palë marrin shërbimet e ndihmës juridike falas, ku padinë e përgatisin me ndihmën e zyrtarëve nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, apo ndonjë organizatë jo-qeveritare që ofron ndihmë juridike falas, ndërsa pala në procedurë gjyqësore nuk përfaqësohet nga zyrtari i ndihmës juridike falas, por nga ndonjë avokat i cili angazhohet për një seancë të vetme dhe jo për rastin në tërësi. Kjo shkakton vështirësi në familjarizimin e avokatëve me rastin apo kualitetin e përfaqësimit në përgjithësi. Për më shumë edhe kriteri financiar i përfitimit nga ndihma juridike falas, nënkupton se vetëm palët të cilëve ju ndërpritet marrëdhënia e punës dhe nuk kanë të ardhura tjera, mund të përfitojnë nga kjo ndihmë.

---

<sup>46</sup> Neni 64 i Ligjit për Konfliktet Administrative.

## 1.7.2. Efektet

### 1.7.2.1. Mosrealizimi i të drejtave në kohë të arsyeshme

Mungesa e efikasitetit në drejtësinë administrative shpjen deri tek rastet e shkeljes së të drejtës së palëve për gjykim në kohë të arsyeshme. Përveç shkeljes së të drejtave, kjo situatë do të ndikoj edhe në kompensimin potencial financiar të palëve, që është shqyrtuar nga Ministria e Drejtësisë në një koncept dokument tjetër.<sup>47</sup> Pavarësisht synimit që Projektligji për Konflikte Administrative e ka në rritjen e efikasitetit, përmes masave të parapara, korniza institucionale e gjykatave dhe veçanërisht numri i gjyqtarëve dhe mbështetja e tyre në trajtimin e konflikteve administrative, është i rëndësishëm kyçe për të rritur këtë efikasitet.

Siç është cekur në pjesën hyrëse, koha në dispozicion për konfliktet administrative – viti 2021, në shkallë të parë ka qenë 798 ditë, ndërsa në shkallë të dytë 426 ditë, dhe në anën tjetër shkalla e spastrimit në shkallë të parë 94% dhe shkalla e dytë 74%.<sup>48</sup> Viti 2021 sipas të dhënave duket se ka ndjekur trendin e njëjtë të viteve 2020 dhe 2019, me dallime të vogla. Por, Kosova në efikasitetin e drejtësisë administrative sa i përket kohës në dispozicion në shkallë të parë, krahasuar me mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) është dukshëm më dobët (787 ditë krahasuar me 492 ditë të BP), apo edhe shkallën e spastrimit në shkallë të dytë (74% krahasuar me 93% të BP).

Numri i konflikteve administrative nga viti 2019 deri në vitin 2022 të iniciuara në DÇA ka qenë në rritje e sipër. Në vitin 2019 janë pranuar gjithsej 3151 padi për iniciimin e konflikteve administrative, në vitin 2020 – 1338 padi (ky vit nuk mund të llogaritet për këtë analizë për shkak të shpërthimit të pandemisë 'Covid-19'), në vitin 2021 – 3295 padi dhe në vitin 2022 – 3408.<sup>49</sup> Pavarësisht që në vitin 2022 një pjesë e lëndëve janë bartur në Gjykatën Komerciale e cila është funksionalizuar në këtë vit (rreth 2000 konflikte administrative në shkallë të parë), një pjesë e madhe e lëndëve mbetet ende në trajtim të DÇA të GJTHP – 6408 lëndë gjithsej, prej të cilave 1548 më të vjetra se 2 vite,<sup>50</sup> apo në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit – 350 raste.<sup>51</sup>

Analizat tregojnë se numri i konflikteve administrative vetëm pritet të rritet gjatë viteve të ardhshme dhe marr parasysh që gjyqtarët aktual pothuajse arrijnë kuotën maksimale të zgjedhjes së lëndëve, e kur konsiderohet që me Projektligjin e ri të Konfliktëve Administrative, të gjitha rastet duhet të zgjedhën në meritë, atëherë duket pothuajse e pamundur që shkalla e spastrimit të rritet pa ngritjen e numrit të gjyqtarëve dhe marrjen e masave të tjera. Më shumë lëndë të reja, me ritëm të njëjtë të efikasitetit, nënkupton se numri i lëndëve të vjetra (mbi 2 vite) vetëm do të rritet.

---

<sup>47</sup> Koncept Dokumenti për Gjykimin në kohë të arsyeshme. I qasshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/KONCEPT-DOKUMENTI-PER-REALIZIMIN-E-TE-DREJTAVE-CIVILE-PERFSHIRE-TE-DREJTEN-E-PALEVE-PER-GJYKIM-BRENDA-KOHES-SE-ARSYESHME.pdf>

<sup>48</sup> Dashboard. Faqe 14. I qasshëm në: <https://rm.coe.int/kosovo-20220630-deliverable-2/1680a8c31d>

<sup>49</sup> Shih raportet statistikore vjetore të KGJK-së. Të qasshme në: <https://www.gjyqesori-rks.org/raportet/?cYear=2023>

<sup>50</sup> Raporti Statistikor Vjetor i vitit 2022. KGJK. Faqe 10. I qasshëm në: <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114-RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf>


<sup>51</sup> Po aty. Faqe 8.

### 1.7.2.2. Humbja e besimit të publikut dhe qasja e kufizuar në drejtësi

Mungesa e efikasitetit të gjykatave krijon besim të ulët të publikut në të dhe si rrjedhojë dekurajimin e tyre për të filluar procedurë gjyqësore për mbrojtjen e drejtave të tyre, apo edhe shqyrtimit të mundësive të tjera për t'i mbrojtur ato.

Kjo dëshmohet edhe nga të dhënat e krahasuara me vendet e BP, ku Kosova ka aktualisht numrin më të vogël të konflikteve administrative të iniciuara.

Figura 9 - Numri i konflikteve administrative të iniciuara, krahasimi i Kosovës me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor (Burimi: Raporti i 'Dashboard')<sup>52</sup>



Pavarësisht, që konfliktet administrative që përfshijnë bizneset do të trajtohen nga Gjykata Komerciale me synim ngritjen e efikasitetit të këyre rasteve, shkeljet e të drejtave të personave fizik kanë gjithashtu ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe ndikojnë në nivelet e migrimit të paligjshëm, krimit apo edhe problemeve tjera të ndërlidhura.

Sipas Raportit të Barometrit Ballkanik, gjashtë nga dhjetë (61%) e të anketuarve në Kosovë i besojnë gjyqësorit, përkundër që mbi një e treta (36%) nuk i beson. Megjithatë, në krahasim me institucionet e tjera si Kuvendi, Qeveria, autoritetet lokale, Avokati i Popullit, Auditori – gjyqësorit i besohet më pak.<sup>53</sup>

<sup>52</sup> Faqe 111. I qasshëm në: <https://rm.coe.int/20220630-wb-dashboard-deliverable-1/1680a8c2dd>

<sup>53</sup> Shih Raportin e Barometrit Ballkanik, opinioni publik, 2022, faqe 123. I qasshëm në: <https://www.rcc.int/download/docs/Balkan%20Barometer%202022%20-%20PO.pdf/21e2192c1d34cc6194ecb029d7b5997f.pdf>

1.7.2.3. Mbikëqyrja e mangët e organeve të administratës publike nga gjyqësori Mungesa e efikasitetit në gjyqësor, dekurajon edhe administratën për të përmirësuar veprimet administrative të ndërmarra, dhe si rrjedhojë përsëritjen e shkeljeve të njëjta në procedura administrative duke ditur se gjykata nuk mund ti mbroj ato në mënyrë efikase.

Në bazë të të dhënave të World Justice Project, në kuadër të nën-faktorit 1.2 - Kompetencat e ekzekutivit kufizohen në mënyrë efektive nga gjyqësori, për vitin 2020, Kosova është ranguar me 0.42 pikë apo në vendin e 92 nga 128 vendet e vlerësuara të Botës. Në vitin 2021, Kosova ka mbetur me pikët e njëjta e ranguar në vendin e 93 nga 139 vendet e vlerësuara, ndërsa në vitin 2022 ka përparuar duke u ranguar me 0.46 pikë apo vendin e 83 nga 140 vendet e vlerësuara.<sup>54</sup>

Pavarësisht progresit në vitin e fundit, Kosova synon edhe të ngritet më lartë duke përmirësuar punën e gjyqësorit.

### 1.7.3. Palët e interesuara

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

Figura 1: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efektet me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykatat	<p>Kapacitetet dhe burimet e pamjaftueshme</p> <p>Mungesa e prioritizimit të drejtësisë administrative dhe kontesteve të punës</p> <p>Fragmentimi i praktikës gjyqësore dhe mungesa e specializimit</p>		<p>Nuk është arritur të sigurohen kapacitetet e mjaftueshme për të rritur efikasitetin e gjyqësorit në drejtësinë administrative dhe në kontestet e punës.</p> <p>Drejtësia administrative është vlerësuar më pak prioritare se sa drejtësia civile dhe ajo penale. Kontestet e punës nuk prioritizohen në raport me kontestet tjera.</p> <p>Unifikimi i praktikës gjyqësore mungon dhe gjyqtarët nuk janë të specializuar sipas kontesteve</p>

<sup>54</sup> World Justice Project. Raportet e vitit 2020, 2021 dhe 2022 për Kosovën. Të qasshme në <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2022/Kosovo>

			(veçanërisht tek kontestet e punës).
Akademia e Drejtësisë	Fragmentimi i praktikës gjyqësore dhe mungesa e specializimit		Nuk ka programe të specializuara/trajnime për gjyqtarët administrativ dhe për ata që trajtojnë kontestet e punës.
Qeveria / organet e administratës publike	Shkaqet tjera lidhur me organet e administratës publike dhe cilësinë e përfaqësimit	Mbikëqyrja e mangët nga gjyqësori	Përfaqësimi nga Avokatura Shtetërore nuk është në kualitetin e duhur.  Administrata publike përsërit shkeljet e njëjta gjatë zhvillimit të procedurave administrative.
Oda e Avokatëve të Kosovës	Shkaqet tjera lidhur me organet e administratës publike dhe cilësinë e përfaqësimit		Njohuritë dhe interesimit për konfliktet administrative nga avokatët mbetet i ulët.
Organizatrat e shoqërisë civile		Humbja e besimit të publikut	Raportet e shoqërisë civile për monitorimin e gjyqësorit tregojnë mungesën e efikasitetit që tutje ndikojnë në humbjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.
Qytetarët		Mosrealizimi i të drejtave në kohë të arsyeshme  Humbja e besimit të publikut  Qasja e kufizuar në drejtësi	Shkelja e të drejtave të njeriut.  Numri i vogël i konflikteve administrative apo kontesteve të punës të iniciuar nga qytetarët, pavarësisht shkeljeve.

## 1.8. Analiza krahasuese

### 1.8.1. Austria

#### Organizimi i drejtësisë administrative

Austria ka një sistem të zhvilluar të drejtësisë administrative dhe është njëra ndër shtetet me traditë të gjatë të kontrollit gjyqësor të aktit administrativ. Sistemi gjyqësor austriak bën dallimin ndërmjet gjykatave të zakonshme dhe gjykatave administrative. Derisa gjykatat e zakonshme merren me çështje

civile dhe penale, gjykatat administrative merren me çështjet administrative duke përfshirë të drejtën administrative penale.

Është me rëndësi të theksohet se Austria, jo shumë larg, ka ndërmarrë një reformë të thellë të organizimit të drejtësisë administrative. Gjykata administrative si gjykata të instancës së parë për herë të parë u themeluan në vitin 2014 duke zëvendësuar tribunalet e pavarura administrative, të cilat plotësonin kriteret e një gjykate sipas nenit 6 të KEDNJ-së por nuk mund të konsiderohet plotësisht gjykata të reja në konceptin kushtetues austriak.<sup>55</sup>

Amendamentet kushtetuese të vitit 2012 mundësuan ndërmarrjen e një reformë madhore të organizimit shtetëror austriak bazuar kryesisht në anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Austria ka këto gjykata administrative:

- Gjykata Administrative Shtetërore [Landesverwaltungsgerichte] – 1 në çdo Land;
- Gjykata Administrative Federale: Gjykata Administrative Federale [Bundesverwaltungsgericht] dhe Gjykata Federale Fiskale [Bundesfinanzgericht]
- Gjykata e Lartë Administrative [Verwaltungsgerichtshof] me seli në Vjenë.

Gjykatat administrative vendosin veçanërisht për ankesat kundër vendimeve dhe akteve administrative të organeve administrative, si dhe për ankesat kundër mosveprimit të autoriteteve administrative brenda afatit të përcaktuar (Säumnisbeschwerden).

Gjykata Federale Fiskale vendos për rastet e apelimit që përfshijnë taksat dhe tarifatat publike (me disa përjashtime) dhe ligjin tatimor penal, me kusht që këto çështje të trajtohen drejtpërdrejt nga autoritetet federale fiskale ose tatimore.

Gjykata Federale Administrative vendos kryesisht për ankesat kundër vendimeve që janë nxjerrë nga autoritetet federale në kontekstin e administrimit të drejtpërdrejtë federal. Përndryshe, zakonisht janë Gjykatat Administrative Shtetërore (të landeve) ato që vendosin për rastet e ankesave administrative. Dallimi midis gjykatave federale dhe gjykatave të Landeve bazohet në juridiksionin varësisht se çfarë lloj autoriteti zbaton ligjin në fjalë.

Vendimet e gjykatave administrative, në rrethana të caktuara, mund të ankimohen në Gjykatën e Lartë Administrative. Gjykata Kushtetuese [Verfassungsgerichtshof] mund të vihet në lëvizje vetëm në rastet që përfshijnë shkelje të kushtetutës, veçanërisht shkelje të të drejtave themelore.

#### Juridiksioni dhe palët e autorizuara

Kushtetuta austriake ka përcaktuar juridiksionin e kontrollit gjyqësor të aktit administrativ duke përcaktuar se

Neni 130 [Rastet e paligjshmërisë]

---

<sup>55</sup> Jakab, András, Arthur Deyevre, and Giulio Itzcovich, eds. *Comparative Constitutional Reasoning*. Cambridge University Press, 2017. F.

Gjykata Administrative shprehet për ankesat në të cilat pretendohet:

- a) paligjshmëria e vendimeve nga autoritetet administrative;
  - b) paligjshmëria në ushtrimin e pushtetit të drejtpërdrejtë administrativ dhe detyrimin ndaj një personi të caktuar; ose
  - c) shkelje e detyrës së autoriteteve administrative për të marrë vendim.
- Gjykata Administrative vendos edhe për ankesat kundër udhëzimeve të marra në bazë të nenit 81a (4).<sup>56</sup>

#### Neni 132 [Ankesa për mosveprim]

Ankesën për shkeljen e detyrës për të marrë vendim mund ta bëjë pala, e cila në procedurë administrative ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e asaj detyre të vendimit.<sup>57</sup>

Duhet theksuar se gjitha kontestet e punës dhe punësimit në Austri i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave të punës dhe çështjeve sociale, pra janë jashtë juridiksionit të gjykatave administrative. **Ligji për Gjykatën e Punës dhe Çështje Sociale** rregullon procedurën në çështjet e së drejtës së punës dhe çështjeve sociale para gjykatave të rregullta. Ligji nuk ka paraparë asnjë detyrim që palët të përfaqësohen nga një avokat para gjykatave të punës dhe çështjeve sociale në shkallë të parë. Afati tipik kohor është afërsisht nga disa muaj deri në dy vjet për zhvillimin e procedurës gjyqësore në shkallë të parë. Disa autoritete publike në Austri janë kompetente për të zbatuar ligjin e punës dhe autoriteti më i rëndësishëm në këtë aspekt është Inspektorati i Punës, i cili monitoron pajtueshmërinë e punëdhënësve me rregulloret statutorë të sigurisë si koha e punës dhe siguria në vendin e punës.<sup>58</sup>

#### Anëtarësia, Emërimet dhe Përbërja

Gjykatat Administrative dhe Gjykata Federale Administrative kanë nga një Kryetar, Zëvendës-Kryetar dhe një numër të caktuar të anëtarëve të tjerë. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe anëtarët e tjerë të Gjykatës Administrative në nivel Landi emërohen nga qeveria e atij Landi.

Duhet theksuar se sa i përket kritereve juridike për tu zgjedhur, gjyqtarët e gjykatave administrative të landeve (njësive federale) duhet të kenë mbaruar studime juridike ose shkenca juridike-politike dhe të kenë të paktën 5 vjet përvojë profesionale juridike.<sup>59</sup>

Për sa i takon procedurës së zgjedhjes në Gjykatën Federale Administrative, Kryetari, Nënkryetari dhe anëtarët e tjerë të Gjykatës Federale Administrative emërohen nga Presidenti Federal me propozim të Qeverisë Federale. Për atë që rekrutimi nuk ka të bëjë me pozitën e Kryetarit apo Zv. Kryetarit, propozimet bëhen nga Mbledhja e Gjyqtarëve (Asamblesë Plenare) të Gjykatës Federale Administrative ose të një komisioni që zgjidhet nga anëtarët e saj, të përbërë nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe të paktën 5 anëtarë të tjerë të Gjykatës Federale Administrative duke renditur tre kandidatë.<sup>60</sup>

<sup>56</sup> Kushtetuta e Austrisë, Neni 130. [https://www.constituteproject.org/constitution/Austria\\_2013.pdf?lang=en](https://www.constituteproject.org/constitution/Austria_2013.pdf?lang=en)

<sup>57</sup> Kushtetuta e Austrisë, Neni 132. [https://www.constituteproject.org/constitution/Austria\\_2013.pdf?lang=en](https://www.constituteproject.org/constitution/Austria_2013.pdf?lang=en)  
[https://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p\\_lang=en&p\\_isn=42850](https://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p_lang=en&p_isn=42850)

<sup>58</sup> Kushtetuta e Austrisë, Neni 134. [https://www.constituteproject.org/constitution/Austria\\_2013.pdf?lang=en](https://www.constituteproject.org/constitution/Austria_2013.pdf?lang=en)

<sup>60</sup> Kushtetuta e Austrisë, Neni 134. [https://www.constituteproject.org/constitution/Austria\\_2013.pdf?lang=en](https://www.constituteproject.org/constitution/Austria_2013.pdf?lang=en)



Anëtarët e Gjykatës Federale Administrative duhet të kenë kryer studime juridike ose shkencë juridiko-politike dhe të ketë të paktën 5 vjet përvojë profesionale juridike. Kurse anëtarët e Gjykatës Federale Administrative Financiare duhet të kenë përfunduar një studim të përshtatshëm dhe të kenë të paktën 5 vjet eksperiencë profesionale ligjore.<sup>61</sup>

Sipas Ligjit Kushtetues Federal të Austrisë, Gjykatat administrative vendosin nëpërmjet gjyqtarëve të vetëm por ligji për procedurën e gjykatave administrative ose ligjet federale mund të përcaktojnë që gjykatat administrative të vendosin përmes dhomave (Senates).

Madhësia e dhomave përcaktohet nga Ligji për organizimin e gjykatës administrative dhe përbërja e tyre përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme që përbëhet nga Kryetari i Gjykatës, Zëvendëskryetari dhe anëtarët e tjerë të Gjykatës së Lartë Administrative.<sup>62</sup> Dhomat zakonisht përbëhen nga 5 gjyqtarë të caktuar, dhe është Kryetari i Gjykatës që cakton çdo çështje ligjore në shqyrtim tek dhoma përgjegjëse për shqyrtimin e çështjes sipas planit të shpërndarjes së punës. Si rregull Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative emëron një anëtar të Dhomës si gjyqtar raportues për çështjen në fjalë.<sup>63</sup> Një gjyqtar mund të jetë anëtar edhe i një dhome tjetër. Anëtarët e Gjykatës së Lartë Administrative emërohen me mandat të pacaktuar por i detyrohen pensionimit të detyrueshëm, e cila është 65 vjeç. Gjykata e Lartë Administrative është e organizuar në 21 dhoma të zgjedhura nga seanca plenare. Rastet janë të shpërndara paraprakisht sipas natyrës së çështjes gjyqësore (të huajt, taksat, financat, ligji i sigurimeve shoqërore, planifikimi urban, ligji për shërbimet publike, etj.). Dhomat përbëhen nga pesë anëtarë (katër gjyqtarë dhe një kryetar i dhomës).

#### Procedura

Në vitin 2014, Austria themeloi një sistem krejtësisht të ri të gjykatave administrative të shkallës së parë (i ashtuquajtur i modeli 9+2): një gjykatë administrative federale e shkallës së parë, një gjykatë federale fiskale e shkallës së parë dhe nëntë gjykata administrative shtetërore. Kundër vendimit administrativ ankuesi mund të bëjë ankim vetëm në gjykatën administrative kompetente të shkallës së parë dhe më pas, ankuesi mund të ankohet kundër vendimit të gjykatës administrative në Gjykatën Kushtetuese dhe/ose në Gjykatën Administrative.<sup>64</sup>

Procedurat para gjykatave administrative zhvillohen në pajtim me kriteret e përcaktuara me nenin 6 të KEDNJ-së, kanë natyrë kontradiktore dhe respektojnë parimin e të drejtave të mbrojtjes dhe pozitës së barabartë ndërmjet palëve të implikuara në proceset gjyqësore. Këto parime e kanë origjinën në të drejtën nacionale (e drejta kushtetuese dhe ligjet kombëtare) duke garantuar palët të drejtën për t'u dëgjuar përcaktuar edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Administrative mund të refuzojë një ankesë si të papranueshme për shkak se nuk është respektuar afati kohor, sepse Gjykata Administrative tashmë e ka gjykuar çështjen, nëse paditësi nuk ka shteruar

<sup>61</sup> Kushtetuta e Austrisë, Neni 134. [https://www.constituteproject.org/constitution/Austria\\_2013.pdf?lang=en](https://www.constituteproject.org/constitution/Austria_2013.pdf?lang=en)

<sup>62</sup> Kushtetuta e Austrisë, Neni 135.

<sup>63</sup> Shih nenin 14 të Ligjit të konsoliduar të Gjykatës Administrative.

<https://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=10000795>

<sup>64</sup> Giera, Ulrike, and Konrad Lachmayer. "The principle of effective legal protection in Austrian administrative law." *The Principle of Effective Legal Protection in Administrative Law*. Routledge, 2016. 73-90.

mjetet e rregullta administrative apo kur paditësi nuk ka kundërshtuar një vendim administrativ (por një akt tjetër), etj.

Kurse qasja në Gjykatën e Lartë Administrative është më e kufizuar për shkak të themelimit të gjykatave administrative të shkallës së parë. Ajo që përbën rishikim (revizion) është i pranueshëm vetëm nëse zgjidhja e çështjes varet nga një çështje ligjore me rëndësi thelbësore. Ky është rasti nëse

- a) vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë devijon nga praktika gjyqësore e vendosur nga Gjykata e Lartë Administrative,
- b) praktika e tillë e vendosur nuk ekziston
- c) ose nëse çështja juridike që duhet zgjidhur nuk i është përgjigjur në mënyrë uniforme nga vendimet e mëparshme.

Ky model e ka ndryshuar kuptimin e Gjykatës së Lartë Administrative në sensin që kontrolli i administratës është kryesisht detyrë e gjykatave administrative të shkallës së parë dhe jo më detyrë e Gjykatës së Lartë Administrative. Funkzioni i Gjykatës së Lartë Administrative tani është të sigurojë ligjshmërinë objektive dhe një praktikë gjyqësore uniforme të gjykatave administrative të shkallës së parë.<sup>65</sup>

Në parim, Gjykata e Lartë Administrative vepron vetëm sipas ankesës. Kushtetuta Federale parashikon disa opsione për trajtimin e një çështjeje ligjore përpara Gjykatës së Lartë Administrative:

- Palët e prekura mund të ankohen në Gjykatën Administrative nëse duan të kundërshtojnë vendimin (gjetjen ose vendimin) e një gjykatë administrative.
- Nëse një gjykatë administrative nuk vendos brenda periudhës së vendimit të dhënë ligjërisht (kjo është zakonisht gjashtë muaj), ata që preken nga kjo rrethanë mund të ndërmarrin veprime kundër këtij dështimi duke paraqitur një kërkesë për një afat.
- Gjykata Administrative vendos edhe për konfliktet e juridiksionit ndërmjet gjykatave administrative ose ndërmjet gjykatës administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative.
- Së fundi, një gjykatë e zakonshme (p.sh. një gjykatë rajonale) mund të bëjë një kërkesë në gjykatën administrative për paligjshmërinë e një njoftimi ose një vendimi të një gjykatë administrative, për aq sa kjo është parashikuar nga legjislatura përgjegjëse.

Duhet theksuar poashtu se nëse në Gjykatën e Lartë Administrative janë ngritur pretendime gjatë procesit se një ligj që do të zbatohet është antikushtetues, atëherë Gjykata e Lartë ndërpre procedurën dhe vendos të referojë dispozitat në fjalë tek Gjykata Kushtetuese (referimi incidental).

Gjykata Administrative gjithashtu ndërpret procedurën nëse lindin pyetje në lidhje me interpretimin ose vlefshmërinë e ligjit të BE-së dhe Gjykata vë në lëvizje procedurën paraprake të vendimit para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJED) për të sqaruar këto çështje (Referimi Preliminar).

Në parim, gjykata administrative duhet ta shqyrtojë çështjen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Është e një rëndësie thelbësore për sistemin gjyqësor administrativ austriak që një gjykatë administrative e shkallës

---

<sup>65</sup> Giera, Ulrike, and Konrad Lachmayer. "The principle of effective legal protection in Austrian administrative law." *The Principle of Effective Legal Protection in Administrative Law*. Routledge, 2016. 73-90.

së parë të vendosë në përgjithësi mbi themelin e çështjes. Vetëm në raste shumë të jashtëzakonshme e anulon aktin e kontestuar dhe kthen çështjen në ri-vendosje te autoriteti publik.

## 1.8.2. Kroacia

### Organizimi i gjykatave administrative

Ligji për Gjykatat i Republikës së Kroacisë rregullon organizimin, kompetencën dhe juridiksionin e gjykatave. Në Republikën e Kroacisë, autoriteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat si organe të veçanta të autoritetit shtetëror, të cilat ushtrojnë autoritetin e tyre në mënyrë autonome dhe të pavarur brenda fushëveprimit dhe juridiksionit të përcaktuar me ligj.<sup>66</sup>

Autoriteti gjyqësor në Republikën e Kroacisë administrohet nga gjykatat e rregullta dhe të specializuara, dhe Gjykata Supreme e Republikës së Kroacisë, e cila është gjithashtu gjykata më e lartë në Republikën e Kroacisë.

Gjykatat e rregullta janë gjykata të cilat merren me çështje për të cilat asnjë gjykatë e specializuar nuk ka juridiksion. Këto janë gjykatat komunale dhe gjykatat e qarkut.

Duhet theksuar se në kuadër të kompetencave të gjykatave komunale si gjykata të rregullta hyjnë edhe kontestet nga marrëdhënia e punës. Në parim dhe si rregull kontestet e punës janë kryesisht kompetencë e gjykatave të rregullta, me të vetmin përjashtim Gjykata e specializuar e Punës e Zagrebit.<sup>67</sup> Disa çështje të veçanta administrative pra të autoriteteve të veçanta mund të dërgohen në gjykata administrative.

#### **A. Anëtarësia, Emërimet dhe Përbërja**

Sipas nenit 90 të Ligjit për Gjykatat të Kroacisë, gjyqtari nuk mund të jetë anëtar i partisë politike ose të angazhohet në veprimtari politike. Zgjedhja e gjyqtarëve në Republikën e Kroacisë rregullohet me Ligjin e Gjykatave (Neni 7 – 23). Ligji për Gjykatat nuk ka paraparë dallime në mes zgjedhjes së gjyqtarëve për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave të specializuara. Për zgjedhjen e gjyqtarëve kusht i përgjithshëm është shtetësia kroate. Pra çdo person që ka mbaruar Shkollën Shtetërore për Zyrtarë Gjyqësorë ose që tashmë është duke kryer detyra gjyqësore mund të emërohet gjyqtar i një gjykate komunale, një gjykatë tregtare ose një gjykate administrative.

Duhet theksuar se Shkolla Shtetërore është njësi organizative e Akademisë së Drejtësisë në të cilën do të fitojnë kandidatët njohuritë dhe aftësitë për sjellje të pavarur dhe të përgjegjshme të funksionit gjyqësor pranë gjykatave të shkallës së parë si dhe zëvendësprokurorët. Ky program zgjat 1 vit dhe përbëhet nga seminare teorike dhe punë praktike të zhvilluara në gjykata dhe prokurori.<sup>68</sup> Sa i takon kriterëve të përvojës së punës, legjislacioni kroat ka përcaktuar se një kandidat që ka punuar si zyrtar gjyqësor për të paktën 10 vjet mund të emërohet gjyqtar i një gjykate të qarkut (županijski sud). Kurse për të shërbyer si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, në Gjykatën e Lartë Tregtare apo në Gjykatën e Lartë

<sup>66</sup> Gazeta Zyrtare Nr. 28/13, 33/15, 82/15, 82/16, 67/18 dhe 126/19).

<sup>67</sup> <https://sudovi.hr/hr/orszg/o-sudovima/o-sudu-0>

<sup>68</sup> Comparative study on the procedure of selection and appointment of judges of administrative court. Ky material është i arritshëm në <https://rm.coe.int/comparative-study-on-selection-of-judges-eng/1680a59e55>.

Administrative të Republikës së Kroacisë kandidati duhet të ketë përvojë si zyrtar gjyqësor për të paktën 12 vjet.<sup>69</sup>

Gjykatat e specializuara janë gjykata të cilat merren me çështjet për të cilat ligji u ka dhënë juridiksion të veçantë. Këto janë

- Gjykatat ekonomike
- Gjykatat administrative
- Gjykatat për kundërvajtje
- Gjykata e Lartë Ekonomike
- Gjykata e Lartë Administrative, dhe
- Gjykata e Lartë për Kundërvajtje

Kontestet administrative zgjidhen nga gjykatat administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative e Republikës së Kroacisë. Gjykatat administrative vendosin:

- për paditë kundër akteve individuale të organeve publike,
- për paditë kundër veprimeve të organeve publike,
- për paditë për shkak të mosmarrjes së një vendimi apo akti individual të organit publik brenda afatit të përcaktuar me ligj.
- për paditë kundër kontratave administrative dhe ekzekutimin e kontratave administrative,
- në raste të tjera të përcaktuara me ligj.<sup>70</sup>

Gjykata e Lartë Administrative vendos për ankesat kundër vendimeve të gjykatave administrative dhe vendimeve të gjykatave administrative kundër të cilave lejohet ankimi, për ligjshmërinë e akteve të përgjithshme, për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave administrative dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.<sup>71</sup>

Në kuadër të Gjykatës së Lartë Administrative të Republikës së Kroacisë funksionojnë 3 departamente:

- Departamenti i Pensioneve, Çështjeve të Invaliditetit dhe Shëndetësisë,
- Departamenti i së Drejtës Financiare dhe Çështjeve të Punës dhe
- Departamenti i së Drejtës Pronësore,

Ligji për Gjykatat ka përcaktuar që Gjykata e Lartë Administrative e Republikës së Kroacisë vendos për ligjshmërinë e akteve të përgjithshme dhe për këtë arsye është themeluar Kolegji për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve të përgjithshme. Ky Kolegj përbëhet nga Kryetari dhe katër gjyqtarë të tjerë. Në punën e kolegjit, përveç gjyqtarëve, merr pjesë edhe një këshilltar i lartë gjyqësor. Mbledhjet e Këshillit

<sup>69</sup> [https://e-justice.europa.eu/29/EN/types\\_of\\_legal\\_professions?CROATIA&member=1](https://e-justice.europa.eu/29/EN/types_of_legal_professions?CROATIA&member=1)

<sup>70</sup> Neni 12 i Ligjit për Konflikt Administrativ. [https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2010\\_02\\_20\\_483.html](https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2010_02_20_483.html)

<sup>71</sup> Neni 12 i Ligjit për Konflikt Administrativ. [https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2010\\_02\\_20\\_483.html](https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2010_02_20_483.html)

mbahen një herë në muaj dhe Këshilli merr vendime për për Kërkesat për Vlerësimin e Ligjshmërisë së akteve të përgjithshme.

### Juridiksioni në çështje administrative

Sipas Ligjit për Konflikt Administrative<sup>72</sup>, objekt i kontestit administrativ në Kroaci janë

- vlerësimi i ligjshmërisë së një vendimi individual me të cilin organi juridik-publik vendos për të drejtën, detyrimin ose interesin juridik të një pale në një çështje administrative (akt administrativ) kundër të cilit nuk lejohet të paraqitet mjete i rregullt juridik;
- vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve të autoritetit publik në fushën e së drejtës administrative me të cilat cenohet e drejta, detyrimi ose interesi juridik i palës ndaj së cilës nuk lejohet të paraqitet mjete i rregullt juridik;
- vlerësimi i ligjshmërisë së mosvendosjes (heshtjes) së autoritetit publik në fushën e së drejtës administrative në afatin e paraparë me ligj për të drejtën, detyrimin ose interesin juridik ose mjetein e rregullt juridik të palës, d.m.th. të veprojë sipas rregullores.
- Vlerësimi i ligjshmërisë së lidhjes, zgjidhjes dhe ekzekutimit të kontratës administrative.

Është me rëndësi të theksohet se objekt i kontestit administrativ është edhe vlerësimi i ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe rajonale (rajonale), personit juridik me autoritet publik dhe personit juridik që kryen shërbim publik.

Ndër veçoritë e reformës së drejtësisë administrative në Kroaci është edhe vlerësimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore.<sup>73</sup>

### 1.8.3. Sllovenia

#### Organizimi i Gjykatave Administrative

Kushtetuta e Sllovenisë përmban disa nene me të cilat është garantuar e drejta për mbrojtje gjyqësore si dhe e drejta për të kërkuar kontroll gjyqësor të aktit administrativ. Kështu, në kuadër të nenit 23 të Kushtetutës është përcaktuar se “çdokush ka të drejtë të ketë një vendim lidhur me të drejtat, detyrat dhe çdo akuzë të ngritur pa vonesë dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj”. Kurse sipas nenit 157 të Kushtetutës, një gjykatë që ka juridiksion për shqyrtimin e akteve administrative vendos për ligjshmërinë e akteve individuale të formës së prerë, me të cilat autoritetet shtetërore, autoritetet vendore dhe bartësit e autoritetit publik vendosin për të drejtat ose detyrimet të të drejtave ligjore të individëve dhe organizatave.<sup>74</sup>

<sup>72</sup> Neni 3 i Ligjit për Konflikt Administrativ. [https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2010\\_02\\_20\\_483.html](https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2010_02_20_483.html).

<sup>73</sup> Për më tepër lidhur me këtë çështje, shih Staničić, F., and Ana Đanić. “„Ocjena ustavnosti i zakonitosti općih akata u hrvatskom pravu i praksa Visokog upravnog suda Republike Hrvatske “.” *Hrvatska i komparativna javna uprava* 4 (2014): 965-974.

<sup>74</sup> Kushtetuta e Sllovenisë, <https://www.us-rs.si/media/constitution.pdf>.

Ligji për Konfliktet Administrative ka përcaktuar organizimin e gjykatave administrative në Slloveni. Ky Ligj ka përcaktuar se Gjykata Administrative e Republikës së Sllovenisë me seli në Lubjanë gjykon në selinë e saj dhe në degët saj sikurse në:

- Degën e Celjes për rrethin gjyqësor që mbulohet nga Gjykata e Lartë e Celjes;
- Degën në Nova Goricë për rrethin gjyqësor që mbulohet nga Gjykata e Lartë në Kopër;
- Degën e Mariborit për rrethin gjyqësor që mbulohet nga Gjykata e Lartë e Mariborit.

Ligji më tej ka specifikuar Gjykata Administrative do të gjykojë në selinë e gjykatës çështjet e azilit, mbrojtjes së konkurrencës dhe çështjet tatimore, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me tatimin mbi të ardhurat dhe çështjet nga Ligji për Tatimin.<sup>75</sup>

Në Republikën e Sllovenisë ekzistojnë edhe katër gjykata të punës dhe çështjeve sociale, të cilat si gjykata të specializuara të shkallës së parë vendosin në kontestet individuale dhe kolektive të punës.

Këto gjykata vendosin lidhur me kontestet në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të sigurimeve shoqërore, të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, të drejtën për sigurim shëndetësor, të drejtën për sigurimin e papunësisë dhe kontestet në lidhje me përfitimet familjare dhe sociale.<sup>76</sup>

Në kontestet e punës, kolegji i gjykatës së shkallës së parë përbëhet nga gjyqtari si kryetar i trupit gjykues dhe dy gjyqtarë porotë si anëtarë të trupit gjykues, njëri prej të cilëve zgjidhet nga lista e kandidatëve/punëtorëve ose personave të siguruar dhe tjetri nga lista e kandidatëve/punëdhënësve apo instituteve.

Gjykata e Lartë e Punës dhe Çështjeve Sociale në Lubjanë është gjykata e shkallës së dytë për gjykimin e vendimeve të nxjerra nga gjykatat e shkallës së parë.

### Juridiksioni

Sistemi gjyqësor i Republikës së Sllovenisë përfshin gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të specializuar.

Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm përfshijnë:

- 44 gjykata vendore
- 11 gjykata rrethi (të dyja gjykatat e shkallës së parë)
- 4 gjykata të larta (gjykatat e juridiksionit të apelit) dhe,
- Gjykata Supreme e Republikës së Sllovenisë.

Kontestet administrative trajtohen në shkallë të parë nga Gjykata Administrative si organ gjyqësor i shkallës së parë, përveç nëse me ligj parashikohet ndryshe.

<sup>75</sup> Neni 9, Ligji për Konfliktin Administrativ, Gazeta Zyrtare Nr. 105/2006.

<sup>76</sup> Shih Ligjin për Gjykatat e Punës dhe Çështjeve Sociale në <http://pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO3657>.

Gjykata Supreme e Republikës së Sllovenisë vendos për konteste administrative që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin Kombëtar, Këshillin Kombëtar dhe për Presidentin e Sllovenisë. Kjo Gjykatë vendos poashtu për ankesën dhe për revizionin si dhe gjykon kontestet lidhur me konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatës administrative dhe një gjykate tjetër.<sup>77</sup>

#### Procedura e emërimit

Nuk duket se ka ndonjë dallim ndërmjet procedurës së zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të gjykatave administrative apo gjyqtarëve të gjykatës të juridiksionit të përgjithshëm. Rekrutimi i gjyqtarëve bëhet me përzgjedhje profesionale dhe nuk ka ndonjë provim shtesë.<sup>78</sup> Megjithatë, Ligji për Konfliktet Administrative përcakton se dispozitat e Ligjit për Shërbimin Gjyqësor zbatohen edhe për pozitën, zgjedhjen, emërimin ose shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Administrative.

Për më tepër, ka një kriter të veçantë që duhet të plotësohet për t'u zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Administrative, siç përcaktohet me Ligjin për Konfliktin Administrativ që është se një kandidati duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara për gjyqtar të gjykatës së lartë ose, duhet të ketë të paktën 10 vjet përvojë në marrjen e vendimeve në çështjet administrative.<sup>79</sup>

#### 1.8.4. Maqedonia e Veriut

##### Organizimi i gjykatave administrative

Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut përmban nene të veçanta kushtetuese që përcaktojnë të drejtën për të kërkuar kontroll gjyqësor të akteve administrative. Në mënyrë të veçantë, kjo e drejtë përcaktohet në nenet vijuese të Kushtetutës:

##### Neni 15

“Garantohet e drejta e ankimit ndaj akteve juridike individuale të nxjerra në procedurë të shkallës së parë nga një gjykatë, organ administrativ, organizatë ose institucion tjetër që kryen funksion publik”

##### Neni 50

“(1) Mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë mund ta kërkojë çdo qytetar para gjykatave të rregullta, si dhe para Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, me procedurë të bazuar në parimet e përparësisë dhe urgjencës.

(2) Garantohet mbrojtja gjyqësore e ligjshmërisë së akteve individuale të administratës shtetërore, si dhe të institucioneve të tjera që ushtrojnë mandate publike.

<sup>77</sup> Ligji për Konfliktin Administrativ, Gazeta Zyrtare Nr. 105/2006, neni 11 dhe 12.

<sup>78</sup> <https://aca-europe.eu/index.php/en/tour-d-europe-en?page=detail&countryid=23>

<sup>79</sup> Ligji për Konfliktin Administrativ, Gazeta Zyrtare Nr. 105/2006, neni 10.

(3) Qytetari ka të drejtë të informohet për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të kontribuojë në mënyrë aktive, individualisht së bashku me të tjerët, në promovimin dhe mbrojtjen e tyre.

Ligji për Gjykatat i vitit 2006 dhe Ligji për Kontestet Administrative të 2006, i amendamentuar në vitin 2010 kanë reformuar ndjeshëm konceptin e mëparshëm të gjyqësorit administrativ në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sistemi i drejtësisë administrative në Maqedoninë e Veriut realizohet përmes Gjykatës Administrative si organ i shkallës së parë dhe Gjykatës së Lartë Administrative. Qëllimi i themelimit të Gjykatës Administrative ka qenë specializimi dhe ngritja e efikasitetit më të madh në gjyqësor në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në fushën e së drejtës administrative. Deri në miratimin e Ligjit për Kontestet Administrative në vitin 2006, zgjidhja e kontesteve administrative ishte në juridiksion të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.<sup>80</sup>

Ligji për Gjykatat në kuadër të nenit 22 ka përcaktuar se “Gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykata Administrative, Gjykata e Lartë Administrative dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë e ushtron pushtetin gjyqësor në kuadër të gjyqësorit”.<sup>81</sup>

Kur është në pyetje drejtësia administrative në Maqedoninë e Veriut, janë tre nivele të gjyqësorit. Niveli i parë përfshin Gjykatën Administrative si gjykatë e shkallës së parë, Gjykatën e Lartë Administrative si gjykatë e shkallës së dytë dhe Gjykata Supreme si gjykatë e cila është kompetente për të vendosur për mjete të jashtëzakonshme juridike. Gjykata Administrative ka selinë në Shkup dhe ka kompetencë territoriale për të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duhet theksuar se Gjykata e Lartë Administrative në kuadrin e saj ka katër departamente/këshilla që mbulojnë fushat vijuese të shqyrtimit gjyqësore

- Departamenti për çështje të pensionit, sigurimit, të drejtave invalide dhe drejtave të tjera
- Departamenti për çështje financiare, doganore dhe të drejta të tjera
- Departamenti për çështje të policisë gjyqësore
- Departamenti për çështje pronësore

## Juridiksioni

<sup>80</sup> <http://www.tribunajuridica.eu/arhiva/An9vS/5.%20Jeton%20Shasivari.pdf>

<sup>81</sup> Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018). Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë: U. nr. 256/2007 datë 16 Prill 2008, U. nr. 74/2008 datë 10 shtator 2008, botuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 118/2008; U. nr. 124/2008 datë 14 janar 2009, botuar në “Fletoren Zyrtare të Republika e Maqedonisë” nr. 16/2009 dhe U. nr. 12/2011 të datës 29 shkurt 2012, botuar në “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 39/2012. [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law\\_on\\_courts.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law_on_courts.pdf)



Ligji për Gjykatat ka përcaktuar kompetencat e Gjykatës Administrative dhe të Gjykatës së Lartë Administrative.

Sipas nenit 34 të Ligjit për Gjykatat, Gjykata Administrative është kompetente për

- ligjshmërinë e akteve individuale të miratuara në procedurën zgjedhore dhe për aktet individuale që kanë të bëjnë me zgjedhjet, emërimet dhe shkarkimet e bartësve të pushtetit publik, nëse përcaktohen me ligj, si dhe për aktet e emërimit, emërimit dhe shkarkimin e nëpunësve drejtues civilë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj,
- kontestet që rezultojnë nga zbatimi i dispozitave të marrëveshjeve koncesionare, kontratat për prokurimet publike të cilat janë me interes publik, dhe në çdo kontratë në të cilën njëra nga palët është shtet organ, organizatë me kompetenca publike, ndërmarrje publike, komuna dhe Qyteti i Shkupit, dhe i cili është lidhur në interes publik ose me qëllim të ofrimit të një shërbimi publik (kontrata administrative),
- kundër akteve individuale të organeve të administratës shtetërore, Qeverisë, organeve të tjera shtetërore, komunat dhe Qytetit të Shkupit, organizatat e themeluara me ligj, dhe personat juridikë dhe personat e tjerë në ushtrimin e kompetencave publike (bartës të pushteteve publike), kur nuk parashikohet një mbrojtje tjetër ligjore<sup>82</sup>

Sipas nenit 30 të Ligjit për Gjykatat, gjykatat themelore kanë kompetencë themelore edhe për kontestet nga marrëdhënia e punës. Këto gjykata krahas kontesteve civile psh konteste pasurore, të martesës dhe shkurorëzimit, alimentacioni, pengim posedimit, etj janë kompetente edhe për gjykimin e kontesteve nga marrëdhëniet e punës.<sup>83</sup>

Gjykata e Lartë Administrative është kompetente për:

- ankesat kundër vendimeve të Gjykatës Administrative;
- për të vendosur në rast të konfliktit të kompetencave ndërmjet organeve të Republikës, ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit, ndërmjet komunave të qytetit të Shkupit dhe në kontestet lidhur me konfliktin e kompetencave ndërmjet komunave dhe qytetit të Shkupit dhe bartësve të kompetencave publike, nëse parashikohen me ligj, në rast se Kushtetuta ose ligjet nuk parashikojnë lloj tjetër të mbrojtjes gjyqësore,
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë<sup>84</sup> është kompetente që të :

- vendos në shkallë të dytë kundër vendimeve të seksioneve të tij, kur përcaktohet me ligj;
- vendos në shkallë të tretë dhe të fundit për ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit;
- vendos për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve juridikisht të vlefshme të gjykatave dhe kundër vendimeve të seksioneve të saj, kur përcaktohet me ligj;

<sup>82</sup> Neni 34 Ligji për Gjykatat.

<sup>83</sup> Neni 30, Ligji për Gjykatat. Shih [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law\\_on\\_courts.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law_on_courts.pdf)

<sup>84</sup> Neni 35, Ligji për Gjykatat.

- vendos për konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatave themelore, konfliktet për kompetencë në mes gjykatave të apelit, konfliktin për kompetencë në mes Gjykatës Administrative dhe një gjykatë tjetër;
- vendos sipas kërkesës së palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë për shkeljen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë në pajtim me rregullat dhe parimet e përcaktuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

#### Emërimet dhe kriteret për zgjedhje të gjyqtarëve

Sipas Ligjit për Gjykatat të Rep. së Maqedonisë së Veriut, gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave i zgjedh dhe i shkarkon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë sipas kushteve dhe në procedurë të përcaktuar me ligj. Në parim në vijim janë kushtet e përgjithshme që një kandidat të zgjedhet gjyqtar:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdor në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të ketë aftësi për punë dhe të ketë gjendje të mirë të përgjithshme shëndetësore, e cila vërtetohet me certifikatë mjekësore,
- të ketë përfunduar arsimin e lartë katërvjeçar për drejtësi ose të ketë përfunduar 300 kredite për drejtësi në studime sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive (ECTS) ose diplomë e vërtetuar për 300 kredite të fituara nga një fakultet juridik i huaj,
- të ketë dhënë provimin gjyqësor në Republikën e Maqedonisë,
- të njohë një nga tre gjuhët e Bashkimit Evropian që përdoren më shpesh (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht),
- në kohën e zgjedhjes të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë ose sanksion kundërvajtës për ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës juridike ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë sanksioni 6 muaj burg,
- të ketë njohuri të punës me kompjuterë, dhe
- të ketë reputacion, integritet në ushtrimin e detyrës gjyqësore dhe aftësi sociale për të ushtruar funksionin gjyqësor.<sup>85</sup>

Ligji për Gjykatat ka përcaktuar kushtet shtesë për gjyqtar në Gjykatën Administrative dhe në Gjykatën e Lartë Administrative duke përcaktuar se:

- kandidati që ka përvojë pune të paktën katër vjet në shërbim të pandërprerë gjyqësor si gjyqtar në gjykatën themelore deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për zgjedhje mund të zgjidhet si gjyqtari i

<sup>85</sup> Neni 45, Ligji për Gjykatat. Ky Ligj mund të arrihet në [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law\\_on\\_courts.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law_on_courts.pdf)

Gjykatës Administrative, i cili vlerësohet nga organi kompetent me vlerësimin pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;

- gjyqtar i Gjykatës së Lartë Administrative mund të zgjidhet personi që ka të paktën 6 vjet përvojë pune si gjyqtar në gjykatën e apelit ose Gjykatën Administrative deri në momentin e aplikimit për zgjedhje, i cili vlerësohet nga autoriteti kompetent me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Gjykatat.

Ligji më tej ka përcaktuar se kandidati i cili ka kryer së paku një mandat si gjyqtar i gjykatës ndërkombëtare dhe i cili i plotëson kushtet nga neni 45 i Ligjit për Gjykatat, mund të zgjidhet gjyqtar në të gjitha nivelet e gjyqësorit.<sup>86</sup>

#### 1.8.5. Shqipëria

##### Organizimi i gjykatave administrative

E drejta e individit për të kërkuar vlerësim gjyqësor që aktit administrativ është e garantuar me dispozita kushtetuese. Kështu, Kushtetuta e Shqipërisë ka përcaktuar se “kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.

Në Republikën e Shqipërisë, pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencat që u ngarkohen atyre me ligj. Gjyqtarët kanë kompetencë të shqyrtojnë të gjitha çështjet penale, civile, administrative si dhe çdo çështje tjetër të përcaktuar me ligj.

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Kur është në pyetje drejtësia administrative, gjykatat administrative janë

- Gjykatat administrative të shkallës së parë
- Gjykata Administrative e Apelit, dhe
- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Në Republikën e Shqipërisë, sipas hartës së re gjyqësore të vitit 2023, janë 2 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, ndërsa 4 ish gjykatat administrative të instancës së parë do të vazhdojnë të kenë zyra administrative ku paditë mund të parashtrohen.

Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë janë kompetente për:

- mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;
- mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;

---

<sup>86</sup> Ligji për Gjykatat, Neni 46 para 2. Ky Ligj mund të arrihet në [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law\\_on\\_courts.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/law_on_courts.pdf)

- mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative;
- mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përfshihen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës;
- kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
- kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
- kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë<sup>87</sup>

Mosmarrëveshjet, të cilat nuk shqyrtohen në gjykatën administrative përfshijnë: a) kontestet të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; b)shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër.<sup>88</sup>

Gjykata administrative e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë mosmarrëveshjet lidhur me kontratat administrative publike dhe kërkesat e paraqitura në zbatim të shkronjave “d” dhe “dh” të nenit 7 të Ligjit për Gjykatat Administrative. Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar. Kurse Gjykata Administrative e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë gjykon me trup gjykues të përbërë: a) me 3 gjyqtarë, ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë; b) me 5 gjyqtarë, paditë ndaj aktit nënligjor normativ.<sup>89</sup>

Ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor ka përcaktuar në vija të përgjithshme aspektet organizative të gjykatave në Shqipëri, të cilat zbatohen në mënyrë analoge edhe për gjykatat administrative si gjykata të specializuara.

Neni 23 i Ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor ka përcaktuar krijimin e seksioneve dhe trupave gjyqësore në gjykata dhe në këtë drejtim ka përcaktuar se për të mundësuar specializimin, gjykata mund të organizohet në seksione kur kjo është e nevojshme, bazuar në kritere objektive, në veçanti në numrin e gjyqtarëve në gjykatë, llojin dhe numrin e çështjeve në të paktën tri vitet e fundit në atë gjykatë. Këto seksione të gjykatave përbëhen nga së paku gjashtë gjyqtarë.<sup>90</sup>

<sup>87</sup> Ligji për Gjykatat Administrative në Shqipëri është i arritshëm në [http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/05/Ligj-49\\_2012-Per-Gjykatat-Administrativ-Perditesuar.pdf](http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/05/Ligj-49_2012-Per-Gjykatat-Administrativ-Perditesuar.pdf).

<sup>88</sup> Ligji për Gjykatat Administrative në Shqipëri, Neni 8.

<sup>89</sup> Ligji për Gjykatat Administrative në Shqipëri, Neni 12.

<sup>90</sup> Neni 23, Ligji për Gjykatat. Shih

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj\\_nr\\_98\\_2016\\_organizimi\\_pushtetit\\_gjyqesor\\_1727.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_nr_98_2016_organizimi_pushtetit_gjyqesor_1727.pdf)

Caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues bëhet duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit. Fillimisht Ligji ka paraparë që të merret mendimi nga mbledhja e përgjithshme të gjyqtarëve, dhe më pas Këshilli i Gjykatës mund të krijojë një ose më shumë seksione në gjykatë dhe cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues.

Megjithatë, nga një analizë më e detajuar e organizimit të gjykatave administrative në Shqipëri rezulton se gjykatat administrative në Shqipëri nuk kanë themeluar seksione apo departamente të veçanta për të trajtuar fusha të caktuara të gjyqësisë administrative. Nga organet që janë operacionalizuar me ligj është Kryetari i Gjykatës dhe Këshilli i Gjykatës, që përbëhet nga tre anëtarët: a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës dhe c) kancelari i gjykatës.<sup>91</sup>

Kompetencat tipike të Këshillit të Gjykatës është miratimi i përshkrimeve të punës për kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor, miratimi i strukturës dhe organikës së administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues pas mendimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, duke ndjekur rregullat e përgjithshme të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; etj.

Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 136/a ka përcaktuar se “gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. Kriteria të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.”

Duhet theksuar fillimisht Ligji nr. 49/2012 për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative ka përcaktuar kriteret për zgjedhjen e gjyqtarëve administrativ duke përcaktuar se

“Gjyqtar në gjykatën administrative të shkallës së parë mund të emërohet shtetasi shqiptar që përmbush kriteret e mëposhtme: a) të jetë gjyqtar jo më pak se 5 vjet; b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit mund të emërohet shtetasi shqiptar që përmbush kriteret e mëposhtme: a) të jetë gjyqtar jo më pak se 9 vjet; b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe të Apelit bëhet nga KLD-ja në dy faza: a) lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret e mësipërme për gjyqtarë në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe të Apelit i dërgohen Shkollës së Magjistraturës për t’iu nënshtruar një testimi seleksionues me shkrim të organizuar prej saj; b) kandidatët që kalojnë me

---

<sup>91</sup> Neni 27 para 1, Ligji i Gjykatave. Në rastet kur Këshilli i Gjykatës vendos për çështje të tjera të ndryshme nga ato disiplinore në lidhje me kancelarin, ai përbëhet nga: a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës; c) gjyqtari i renditur më pas, i zgjedhur në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 5, të këtij ligji. 4. Në rastet kur Këshilli i Gjykatës vepron si komision disiplinor në procedimin ndaj nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, ai përbëhet nga: a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës; c) një nëpunës i lartë civil gjyqësor i Këshilli të Lartë Gjyqësor, i caktuar nga ky i fundit. 5. Nëse Këshilli i Gjykatës për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk e siguron përbërjen e përcaktuar, sipas parashikimeve të pikave 3 dhe 4, të këtij neni, atëherë kryetari i gjykatës së apelit me juridiksion të përgjithshëm vepron si anëtar zëvendësues në Këshillin e Gjykatës.

sukses testimin seleksionues, përzgjidhen nga KLD-ja, duke mbajtur parasysh rezultatet e testimit seleksionues.

Por me ndryshimet e bëra në Ligjin nr. 49/2012 për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, neni 5 që flet lidhur me kriteret për gjyqtar administrativ është shfuqizuar (ndryshuar me ligjet nr.100, datë 31.7.2014, nr. 39/2017, datë 30.3.2017).<sup>92</sup>

## Kapitulli 2: Objektivat

Ministria e Drejtësisë në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, ka paraparë "Reformimin e sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative". Në këtë drejtim, në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, qëllimi strategjik 9.1. Drejtësi efektive, nën-qëllimi strategjik 9.1.1. Drejtësi me kohë, është paraparë hartimi i këtij Koncept Dokumenti.

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
<i>Qëllimi strategjik –</i> Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025  Plani Kombëtar për Zhvillim
<i>Objektiva specifike –</i>  Zgjidhja e të gjitha konflikteve administrative më të vjetra se dy vite, si dhe zvogëlimi për 50% i kohës në dispozicion sipas indikatorit të CEPEJ për 50% në shkallën e parë dhe 30% në shkallën e dytë, deri në vitin 2026.	Sipas këtij Koncept Dokumenti.
<i>Qëllimi i politikës –</i>  Themelimi i kornizës institucionale adekuate për trajtimin e kontesteve administrative dhe të punës	Sipas këtij Koncept Dokumenti.

<sup>92</sup> [https://www.gjykataehapur.al/wp-content/uploads/2018/10/Ligj\\_49\\_03052012\\_perditesuar\\_2017.pdf](https://www.gjykataehapur.al/wp-content/uploads/2018/10/Ligj_49_03052012_perditesuar_2017.pdf)

## Kapitulli 3: Opsionet

Bazuar në analizën e problemit më lartë dhe objektivat që synohen të arrihen, grupi punues ka shqyrtuar gjithsej katër opsione.

### Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni i parë që është trajtuar nga grupi punues është opsioni asnjë ndryshim. Në bazë të këtij Opsioni do të vazhdohej me dy departamentet për çështje administrative në kuadër të GJTHP dhe Gjykatës së Apelit, si dhe me Gjykatën Komerciale si entitet i veçantë për të trajtuar konfliktet administrative që përfshijnë në cilësinë e palës paditëse bizneset.

Gjithashtu, kontestet e punës do të vazhdonin të trajtoheshin në kuadër të DÇA të GJTHP dhe divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme në kuadër të gjykatave themelore sa i përket shkallës së parë, përfshirë edhe ndarjen e kontesteve të të punësuarve në institucione publike në mes të departamentit dhe divizioneve të lartpërmendura, varësisht nga statusi i të punësuarit. Gjithashtu në kuadër të Gjykatës së Apelit këto konteste do të vazhdonin të trajtohen në kuadër të departamenteve të ndryshme.

Siç është argumentuar edhe në përkufizimin e problemit, nëse mbetet gjendja aktuale, gjegjësisht pa ndryshime organizative institucionale e as masa tjera, efikasiteti në konfliktet administrative dhe kontestet e punës do të vazhdonte të mbetej i ulët dhe të gjitha shkaqet që e dëmtojnë efikasitetin do të vazhdoheshin të jenë relevante, madje efikasiteti mund të jetë edhe më i ulët në të ardhmen duke konsideruar se pritet rritja e numrit të konflikteve administrative në të ardhmen.

### Kapitulli 3.2: Opsioni për fuqizimin e kapaciteteve pa ndryshime organizative

Opsioni 2 i shqyrtuar dhe diskutuar nga grupi punues është opsioni për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore pa ndryshime organizative institucionale, pra pa ndryshime ligjore organizative apo të kompetencave.

Ky opsion në mënyrë specifike përfshin:

#### 1. Rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës:

Në të DÇA të GJTHP do të shtoheshin edhe 8 gjyqtarë të rinj, përmes procesit të rekrutimit të zhvilluar nga KGJK, që do të çonte numrin total të gjyqtarëve në këtë departament në 14 (ngase 3 nga gjyqtarët aktual do të transferoheshin në Gjykatë të Apelit siç do të shpjegohet në vijim). Rritje të numrit të gjyqtarëve pra do të kishte edhe në Gjykatën e Apelit, ku 4 gjyqtarëve aktual do t'u shtoheshin dhe 3 gjyqtarë tjerë të transferuar nga DÇA në Gjykatën e Apelit.

Në anën tjetër, sa i përket kontesteve të punës, nuk do të kishte rritje të numrit të gjyqtarëve në divizionet civile, por sipas vendimit të KGJK-së/kryetarëve të gjykatave do të caktoheshin 2 gjyqtarë që do të merreshin ekskluzivisht me kontestet e punës në Divizionit Civil të GJTHP dhe nga 1 gjyqtari në secilin divizion civil të departamenteve të përgjithshme të gjykatave themelore në Kosovë;

Bashkëpunëtorët profesional gjithashtu do të shtoheshin duke u rekrutuar 5 bashkëpunëtor të rinj në DÇA të GJTHP dhe 2 të tjerë në Gjykatën e Apelit.

## 2. Programet e specializuara të trajnimit

Opsioni 2 parasheh krijimin dhe miratimin nga Këshilli i Akademisë së Drejtësisë i pesë programeve të specializuara të trajnimit nga Akademia e Drejtësisë, për Projektligjin e ri për Konfliktet Administrative si dhe për llojet e ndryshme të konflikteve administrative. Në këto trajnime përfshihen edhe avokatët shtetëror në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe përfaqësuesit tjerë të institucioneve publike në procedura gjyqësore, nga institucionet tjera si ato të pavarura, apo komunat.

Programi do të përcillej me trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët administrativ dhe do të zgjerohet për atë që është relevante edhe tek gjyqtarët e DÇA dhe Departamentit Fiskal të Gjykatës Komerciale.

Sipas këtij Opsioni, parashihet edhe krijimi i Programit të trajnimit nga Oda e Avokatëve për Projektligjin e ri për Konfliktet Administrative, për të mbajtur trajnime specifike me avokatët dhe avancuar njohuritë e tyre për drejtësinë administrative.

### Kapitulli 3.3: Opsioni për ndryshime organizative ligjore

Në kuadër të këtij Opsioni trajtohen nën-opsione të ndryshme sa i përket drejtësisë administrative dhe kontesteve të punës.

Së pari, sa i përket drejtësisë administrative nën-opsionet janë: 1) zgjerimi i kompetencës së Gjykatës Komerciale për të gjitha kontestet administrative dhe 2) themelimi i Gjykatës së re Administrative të veçantë.

Sipas **nën-opsionit 1 për drejtësinë administrative**, Ligji për Gjykatën Komerciale do të ndryshohej për të përfshirë në kompetencë të kësaj Gjykate të gjitha konfliktet tjera administrative që aktualisht janë në kompetencë të departamenteve për çështje administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit. Për të reflektuar ndryshimin e juridiksionit, emri i kësaj Gjykate do të ndryshohej në Gjykatën Komerciale dhe Administrative.

Këto raste do të trajtoheshin në kuadër të një departamenti shtesë të krijuar në kuadër të Dhomës së Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, që do të trajtonte ekskluzivisht konfliktet administrative në të cilat si paditës përfshihet individ – personi fizik në raste si nga skemat sociale, shërbimet publike, konfliktet lidhur me ndërtimet dhe konflikte të tjera administrative. Kurse, DÇA dhe Departamenti Fiskal në kuadër të Gjykatës Komerciale do të vazhdonte me juridiksionin/kompetencat e njëjta për trajtimin e konflikteve administrative, ku në cilësinë e paditësit paraqiten bizneset.

Sipas **nën-opsionit të dytë për drejtësinë administrative**, me një Ligj të ri do të themelohej Gjykata Administrative e Kosovës. Karakteristikat kryesore të kësaj Gjykate janë:

- Gjykata do të funksiononte si Gjykatë Administrative Qendrore me seli në Prishtinë dhe kompetencë për tërë territorin e Kosovës.
- Gjykata do të funksionoj me dy shkallë: shkalla e parë (që do të përfshinte kompetencën e Departamentit Administrativ aktual në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si dhe kompetencën e Departamentit për Çështje Administrative dhe Departamentit Fiskal në Gjykatën Komerciale ) dhe shkallën



e dytë siç edhe parashihet me Projektligjin për Konfliktet Administrative. Pra, Gjykata e re Administrative do të trajtonte të gjitha konfliktet administrative.

- Gjykata do të trajtonte gjithashtu kontestet e punës ku në cilësinë e të paditurës është institucioni publik, pavarësisht statusit të të punësuarit – nëpunës civil, nëpunës i shërbimit publik, etj.

- Gjykata do të ndahej në disa departamente, ku disa prej tyre mund të jenë: 1) Departamenti për konflikte administrative të ndërlidhura me veprimtarinë ekonomike të shoqërive tregtare; 2) Departamenti Fiskal; 3) Departamenti për çështjet nga skemat sociale; 4) Departamenti për kontestet e punës ku në cilësinë e të paditurës është institucioni publik; 5) Departamenti për çështjet lidhur me pronën, ndërtimin dhe çështjet mjedisore; 6) Departamenti i Përgjithshëm – të gjitha çështjet tjera që nuk janë në fushëveprim të departamenteve tjera.

- Departamentet konkrete të Gjykatës Administrative do të përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor, varësisht nga ngarkesa dhe natyra e lëndëve.

- Nëse llogariten të dhënat në fund të vitit 2022 rezulton se në DÇA të GJTHP kanë qenë 7173 lëndë të pazgjidhura pra konflikte administrative (duke përfshirë edhe të dhënat nga Divizioni Fiskal, deri në gusht të vitit 2022), 2376 konflikte administrative në Gjykatë Komerciale, ndërsa konteste të punës të sektorit publik rreth 5639, apo përafërsisht 75% e numrit total të kontesteve të punës në divizionet civile në vitin 2021 – 7519 konteste. Duke llogaritur se një pjesë e madhe e këtyre kontesteve janë nga kontratat kolektive (rreth 40%)<sup>93</sup>, rezulton se rreth 3383 konteste të punës janë të tjera me institucionet publike, e që një numër i ngjashëm përafërsisht mund të bartet në Gjykatën e re Administrative. Pra Gjykata Administrative me juridiksionin e propozuar sipas këtij nën-opsioni, me shkallën e zgjidhjes së vitit 2022, e që nuk pritet të ndryshohet dukshëm në vitin 2023, kur të themelohet, mund të ketë rreth 13000 lëndë. Duke konsideruar lëndët e reja të pranuar (konflikte administrative) gjatë vitit 2022, që është 3825 dhe se ky numër mund të rritet me zbatimin e Projektligjit për Konflikte Administrative dhe vetë themelimin e Gjykatës, numri i lëndëve të reja mund të rritet afërsisht deri në 5000 lëndë për vit. Marr parasysh mesataren e zgjedhjes së lëndëve në mes të gjyqtarëve të DÇA të GJTHP dhe divizioneve civile e që është 22.85 lëndë në muaj për një gjyqtar gjatë vitit 2022, rezulton se Gjykata Administrative duhet të ketë së paku 25 gjyqtarë në shkallë të parë për të mbajtur shkallën e spastrimit më lartë se 100% gjatë viteve të ardhshme, ulur kohën në dispozicion për zgjidhjen e rasteve dhe zgjedhur në mënyrë efikase lëndët e vjetra të grumbulluara brenda 6 viteve. Sa i përket shkallës së dytë, minimum duhet të shërbejnë 69 gjyqtarë, pra 23 kolegje. Këta gjyqtarë duhet të përcjellën me po aq numër të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor.

- Gjyqtarët aktual të DÇA të GJTHP, DÇA të Gjykatës së Apelit, si dhe DÇA dhe Departamentit Fiskal të Gjykatës Komerciale, do të transferohen sipas fuqisë së Ligjit të ri, në Gjykatën e re Administrative.


- Gjykata do të ketë stafin tjetër mbështetës administrativ në përputhje me planifikimet e KGJK-së.

---

<sup>93</sup> Shih Raportin e IKD-së ku evidentohet se rreth 40% të lëndëve të pranuar në vitin 2021 janë nga mos-zbatimi i kontratave kolektive. I qasshëm në: <https://kli-ks.org/ikd-ngarkesa-e-gjykatave-me-lende-civile-si-pasoje-e-kontrates-kolektive/>

Ky nën-opcion nënkupton gjithashtu plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Gjykata. Kurse sa i përket pjesës së kundërvajtjeve, grupi punues ka vlerësuar që të vazhdohet me kompetencën aktuale të divizioneve të kundërvajtës për shkak të praktikës së krijuar dhe adresimit deri tash në mënyrë efektive të këtyre rasteve.

Figura 10 - Dallimi në mes të dy nën-opsioneve për drejtësinë administrative



Në anën tjetër, sa i përket kontesteve të punës gjithashtu janë shqyrtuar tre nën-opsione: 1) themelimi i divizioneve të veçanta për kontestet e punës; 2) bartja e të gjitha kontesteve të punës ku si e paditur është institucioni publik në Gjykatën Administrative; dhe 3) themelimi i Gjykatës së re të Punës.

Sipas nën-opsionit të parë për kontestet e punës, divizionet e veçanta për kontestet e punës themelohen në kuadër të departamenteve të përgjithshme të të gjitha gjykatave themelore, me një numër të caktuar të gjyqtarëve për kontestet e punës.

Kompetenca territoriale sa i përket këtij nën-opsioni do të mbetet e njëjtë, pasi që të gjitha gjykatat themelore do të vazhdonin të trajtonin kontestet e punës nga sektori privat, vetëm se ato nga sektori publik siç janë për nëpunësit e shërbimit publik do të barteshin tek forma që merr gjykata administrative e ardhshme. Kjo do të reflektohej edhe tek Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit.

Ky nën-opcion nënkupton ndryshime të nivelit të akteve nënligjore për rregullimin e juridiksionit të divizioneve të reja civile, gjegjësisht ndryshimin e strukturës organizative nga KGJK, por edhe ndryshimet ligjore organizative për gjykatën administrative.

Largimi i kontesteve të punës me institucionet publike nga departamentet e përgjithshme/divizionet civile të gjykatave themelore dhe bartja e tyre tek gjykata administrative, do të zvogëlonte konsiderueshëm barrën që këto divizione aktualisht e kanë, dhe veçanërisht GJTHP, Gjykata Themelore e Gjilanit dhe ajo e Pejës. Kjo do të rriste pastaj efikasitetin e këtyre divizioneve në trajtimin e kontesteve të punës nga sektori privat, kur merret parasysh edhe fakti se 48 gjyqtarë të rinj janë aktualisht në trajnim fillestar dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre do të jetë pjesë e divizioneve civile të gjykatave themelore, por edhe fakti se KGJK rishtazi ka zhvilluar edhe raundin e ri të rekrutimit të gjyqtarëve për 37 gjyqtarë të rinj, të cilët pritet të fillojnë trajnimin fillestar gjatë këtij viti.

**Nën-opsioni i dytë për kontestet e punës** përfshin gjithashtu ndryshimin e kompetencës për divizionet civile në kuadër të gjykatave themelore si dhe të divizionit civil të Gjykatës së Apelit, por jo krijimin e ndonjë divizioni të ri. Ky ndryshim kompetence nënkupton se këto divizione do të trajtojnë vetëm kontestet e punës nga sektori privat, pra ku i paditur/punëdhënës është sektori privat – pra jo institucioni publik. Të gjitha kontestet tjera të punës me institucionin publik do të trajtohen nga cilado formë që merr Gjykata Administrative sipas nën-opsioneve të trajtuara më lartë për drejtësinë administrative.


Ky nën-opsion përfshin ndryshime në nivel të akteve nënligjore të KGJK-së si dhe ligjore lidhur me juridiksionin e gjykatës administrative.

**Nën-opsioni i tretë për kontestet e punës** është themelimi i Gjykatës së veçantë të Punës përmes nxjerrjes së një Ligji të ri për këtë Gjykatë. Karakteristikat kryesore të Gjykatës së Punës janë:

- Gjykata do të funksiononte si Gjykatë Qendrore e Punës me seli në Prishtinë dhe kompetencë për tërë territorin e Kosovës, apo si Gjykatë me divizione edhe në rajone të tjera të Kosovës.
- Gjykata do të funksionoj me dy shkallë: shkalla e parë (që do të përfshinte kompetencën e divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme të gjykatave themelore) dhe shkallën e dytë (që do përfshin kompetencën e Divizionit Civil aktual në Gjykatën e Apelit);
- Gjykata do të ketë në kompetencë të gjitha kontestet e punës pavarësisht statusit të punëdhënësit, sektori privat apo sektori publik.
- Gjykata do të ndahej në tre departamente që mund të jenë: 1) Departamenti për kontestet nga marrëdhënia e punës në sektorin privat; 2) Departamenti për kontestet nga marrëdhënia e punës në sektorin publik dhe 3) Departamenti për kontestet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Dy departamentet e para do të trajtonin të gjitha kontestet që kanë të bëjnë me konkursat, kontratat, ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës, vazhdimin të punësimit, sistemit të përkohshëm, masat disiplinore, pagat dhe të drejtat tjera të të punësuarve. Departamenti i tretë do të trajtonte ekskluzivisht çështjet që ndërlidhen me shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve, lidhur me lëndimet, pasojat shëndetësore të të punësuarve, mos-respektimin e masave për sigurinë dhe shëndetin e tyre dhe të ngjashme.
- Divizionet në kuadër të këtyre departamenteve do të themeloheshin varësisht nga planifikimet e KGJK-së, bazuar në ngarkesën e lëndëve.

- Numri i përafërt i gjyqtarëve që do të shërbejnë në këtë Gjykatë do të jetë 15 gjyqtarë (9 në shkallën e parë dhe 6 në shkallën e dytë), e përcjellur me po aq numër të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor.
- Gjykata do të krijon gradualisht edhe shërbimet e brendshme administrative me mbështetje të gjykatave tjera ekzistuese dhe në përputhje me planifikimet e KGJK-së.

Figura 11 - Nën-opsionet për kontestet e punës



Pavarësisht nën-opsioneve të ndryshme për drejtësinë administrative dhe kontestet e punës të elaboruara më lartë, janë konsideruar edhe disa masa të veçanta që do të kontribuonin në rritjen e efikasitetit dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve në përgjithësi.

Këto masa kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe avokatëve në njërën anë dhe masave për ndihmën juridike falas dhe tarifat gjyqësore për palët.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve në kuadër të këtij Opsioni, por që mund të konsiderohen edhe në Opsionin 2 të këtij Koncept Dokumenti janë:

- Programi i zhvilluar i trajnimit të trajnerëve nga Akademia e Drejtësisë për Projektligjin e ri për Konfliktet Administrative. Certifikimi i një numri të caktuar të trajnerëve për këtë Projektligj dhe organizimi i trajnimeve të veçanta për gjyqtarët, avokatët shtetëror dhe bashkëpunëtorët profesional lidhur me Projektligjin e ri.

- Programe të specializuara të trajnimit nga Akademia e Drejtësisë për: 1) kontestet e punës; 2) kontestet lidhur me gjobat administrative 2) kontestet nga skemat sociale dhe 3) kontestet lidhur me ndërtimin, regjistrimin e pronës dhe çështjet mjedisore.
- Program i specializuar i trajnimit për Projektligjin e ri për Konfliktet Administrative nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe së paku 8 trajnime të mbajtura në vit, për tre vitet e ardhshme: 2024, 2025 dhe 2026.
- Tryeza për të unifikuar praktikën gjyqësore në mes të gjykatave me gjykatat më të larta. Tryezat mund të ndahen sipas temave, ku kontestet e punës natyrisht se do të ishin një nga temat e veçanta të trajtuara.

Masat për ndihmën juridike falas dhe tarifat gjyqësore të planifikuara në kuadër të këtij nën-opsioni janë:

- Ndryshimi i Ligjit për Ndihmë Juridike Falas për të ofruar ndihmë juridike të detyrueshme falas për çdo person të punësuar në sektorin privat të cilit/cilës i ndërprehet marrëdhënia e punës, apo fillon konteste lidhur me mos-zbatimin e masave të shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Caktimi i avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike falas për rastin në tërësi dhe jo vetëm për një seancë.
- Kategoria e të punësuarve në sektorin privat përjashtohen nga pagesa e tarifave gjyqësore në bazë të ndryshimeve legislative për tarifat gjyqësore.
- Rikonsiderimi i tarifave aktuale gjyqësore për iniciimin e konflikteve administrative (aktualisht sipas Rregullores së KGJK-së 50 euro) dhe veçanërisht ato për paraqitjen e ankesës në shkallë më të lartë (aktualisht 30 euro) për kategori të caktuara.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës. Ndikimet e pritura vlejné për të gjitha opsionet e shqyrtuara në Kapitullin 3.

Figura 12 - Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet shoqërore	Ndikime në të drejtat e punëtorëve dhe informimin më të mirë të publikut
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet në të drejtat themelore	Ndikime në mënyrën se si administrata i merr vendimet dhe ndikime në qasjen në drejtësi

Ndikimi gjinor	Nuk është zhvilluar vlerësimi i ndikimit gjinor për shkak të mungesës së të dhënave
Ndikimet e barazisë sociale	Parashihen masa për të adresuar sfidat që ballafaqohen kategori të veçantë – siç janë të punësuarit në sektorin privat
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta

## Kapitulli 4.1. Ndikimet shoqërore

### 4.1.1. Ndikimet në të drejtat e punëtorëve

Opsionet e shqyrtuara në këtë Koncept Dokument kanë adresuar trajtimin e kontesteve të punës nga Gjykatat, qoftë ato të punëtorëve me sektorin privat apo edhe me sektorin publik, andaj rrjedhimisht ndikojnë në të drejtat e punëtorëve.

Përmes Opsionit 1 të Koncept Dokumentit, të trajtuar më lartë e që vazhdon gjendjen ekzistuese, nuk pritet që të ketë ndonjë ndikim pozitiv në të drejtat e punëtorëve. Në mungesë të riorganizimit institucional të gjyqësorit apo edhe ndërmarrjes së masave tjera, do të vazhdohet me efikasitetin e ulët në trajtimin e kontesteve të punës, ku veçanërisht problematike do të mbetet numri i vogël i kontesteve të punës të iniciuara në Gjykatë nga punëtorët në sektorin privat si rrjedhojë e mos-besimit në sistemin aktual, por edhe kohëzgjatjes së procedurave të njëjta në kuadër të divizioneve civile të shtatë gjykatave themelore në Kosovë. Vazhdimi i problemeve të njëjta, do të stimulonte gjithashtu vazhdimin e shkeljes së të drejtave të punëtorëve.

Masat e parapara në Opsionin 2 gjithashtu nuk duket se do të mund të ndikojnë dukshëm në përmirësimin e të drejtave të punëtorëve. Një përparësi mund të jetë që gjyqtarët do të pranonin trajtime shtesë për këto konteste, por në mungesë të riorganizimit institucional, këta gjyqtarë do të trajtonin edhe konteste tjera qoftë civile apo administrative, dhe si rrjedhojë edhe specializimi nuk do të prodhonte efektin e duhur që të rritet profesionalizmi në trajtimin e këtyre rasteve.

Opsioni 3, që është opsioni për ndryshime organizative ligjore ndikon më së shumti të drejtat e punëtorëve. Së pari, sa i përket dy nën-opsioneve për kontestet e punës duket se nën-opsioni për themelimin e Gjykatës Administrative të veçantë, në raport me nën-opsionin për zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës Komerciale, duket se do të ketë një efekt më të madh në priorizimin e kontesteve të punës në përgjithësi. Vetë ekzistimi i gjykatave të veçanta mundëson një efikasitet më të madh, organizim më të mirë dhe më të pavarur të resurseve, kryetar të veçantë që mbikëqyr punën, shërbime mbështetëse të veçanta, por edhe vëmendje e priorizim të punës së tyre në raport me Këshillin Gjyqësor. Të qenurit në një Gjykatë më të madhe siç është konsideruar në nën-opsionin e dytë të Opsionit 3, pra Gjykatën Komerciale dhe Administrative, priorizimi i kontesteve të veçanta, siç janë kontestet e punës, duket të jetë më pak i mundshëm. Kjo ka ndikim edhe në besimin e publikut në raport me gjyqësorin, ngase për shembull themelimi i një Gjykate të veçantë të specializuar në krahasim me gjykatat tjera ekzistuese, apo departamenti ose divizioni në kuadër të asaj Gjykate për kontestet e punës, rrit besimin dhe ndikon që punëtorët të iniciojnë e fitojnë më shumë raste gjyqësore ndaj punëdhënësve, që pastaj rezulton në

edukimin më të madh të punëdhënësve dhe evitimin e shkeljes së të drejtave të punëtorëve në të ardhmen.

Sa i përket nën-opsioneve për kontestet e punës, të trajtuara në kuadër të Opsionit 3, duket se nën-opsioni i parë (themelimi i divizioneve të veçanta për kontestet e punës) dhe ai i tretë (Gjykata e Punës) ndikojnë më shumë në përshtypjet dhe besimin e publikut në gjyqësor, veçanërisht për të punësuarit në sektorin privat, në raport me nën-opsionin e dytë që vazhdon organizimin e njejtë institucional sa i përket trajtimit të kontesteve të punës të sektorit privat në kuadër të divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme. Ngjashëm, me këto dy nënopsione priorizohen kontestet e punës dhe ndikohet drejtpërdrejt efikasiteti i gjykatës në trajtimin e tyre dhe duke ditur se efikasiteti sjell edhe besim, por edhe edukim të punëdhënësve, mendohet se të drejtat e punëtorëve mbrohen më mirë kështu,

#### 4.1.2. Ndikimet në informimin më të mirë të publikut

Sa më të specializuara ose të veçanta të jenë gjykatat që trajtojnë kontestet e palëve, në këtë rast ato administrative por edhe kontestet e punës, aq më i mirë dhe më efikas bëhet informimi i publikut. Rrjedhimisht Opsioni 3 i trajtuar ka përparësi të dukshme krahasuar me dy opsionet tjera. Në kuadër të Opsionit 3, duket se nën-opsioni për themelimin e Gjykatës së veçantë Administrative dhe ai për themelimin e Gjykatës së Punës kanë ndikim edhe më pozitiv se sa nën-opsionet tjera të shqyrtuara të Opsionit 3.

### Kapitulli 4.2. Ndikimet në drejtat themelore

#### 4.2.1. Mbikëqyrja gjyqësore e administratës publike

Një gjyqësor efikas që mbikëqyr organet e administratës publike ndikon që këta të fundit të përmirësojnë vendimet e tyre. Për të siguruar një mbikëqyrje të duhur, janë dy elemente kyçe që do të konsiderohen në kuadër të opsioneve të trajtuara. Së pari, 1) efikasiteti – cili opsion i mundëson gjykatës të veprojnë dhe zgjidh lëndët më shpejtë; dhe 2) specializimi – cili opsion mundëson specializim më të madh për gjyqtarët, ashtu që vendimet e tyre të jenë kualitative dhe të edukojnë administratën publike për të ardhmen. Opsioni 1 natyrshëm pamundëson fuqizimin e këtyre elementeve, deri sa Opsioni 2 siguron specializim por i mungon aspekti vendimtar i efikasitetit. Për deri sa specializimi do të përcjellët me cilindo nga nën-opsionet e Opsionit 3, sigurisht që dy Gjykatat e specializuara, ajo e veçantë Administrative, por edhe Gjykata e Punës, meqë ndahen si të veçanta, priorizohen dhe kanë resurse të veçanta, duket se sjellin më shumë efikasitet.

#### 4.2.2. Qasja në drejtësi

Për të rritur qasjen në drejtësi, janë paraparë masa të veçanta si shtesë pavarësisht vendimit për ndryshimet organizative të gjyqësorit të trajtuara në kuadër të Opsionit 3. Këto masa, siç është cekur më lartë, kanë të bëjnë me fuqizimin e ndihmës juridike falas përfshirë zgjerimin e kategorive përfituese, por edhe zvogëlimin e tarifave gjyqësore, që gjithsesi kanë ndikime shumë më pozitive se sa Opsioni 1 dhe 2 të shqyrtuara në këtë Koncept Dokument.

Përmes këtyre masave, por edhe ndryshimeve organizative të gjyqësorit, pavarësisht nivelit të themelimit të njësive/gjykatave të specializuara, por veçanërisht edhe miratimit të Projektligjit të ri për Konfliktet Administrative vlerësohet se do të rritet numri i kontesteve të punës nga sektori privat (që tanimë nuk është në nivelin e lartë marr parasysh shkeljet e të drejtave të punëtorëve), por edhe konflikteve administrative në përgjithësi duke ditur se Kosova aktualisht ka numrin më të vogël në 100 banorë që iniciojnë kësi lloji të konflikteve krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor.

#### Kapitulli 4.3. Ndikimet buxhetore

Opsioni 3, specifikisht nën-opsioni 3.2., do të ketë kosto buxhetore shtesë, e paraqitur në Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për vitin 2024 973,586.88, vitin 2025 1,022,266.22 dhe vitin 2026 1,073,379.54, ndërsa totali është gjithsejtë 4,011,232.64.

#### Kapitulli 4.4: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Sfidat më të mëdha të mbledhjes së të dhënave për këtë Koncept Dokument, kanë qenë në shifrat e sakta të kontesteve të punës të trajtuara nëpër gjykatat e Kosovës, si dhe shifrat për dallimin në mes të kontesteve të punës nga sektori publik në krahasim me ato nga sektori privat. Gjithashtu, vështirësi ka pasur në mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, që do të mundësonte çfarëdo analize për vlerësimin e ndikimit gjinor të opsioneve të shqyrtuara në këtë Koncept Dokument.

### Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Në vijim është paraqitur plani për komunikimin dhe konsultimin e këtij Koncept Dokumenti, që është realizuar dhe ka përfshirë aktivitete të ndryshme në këtë drejtim.

Figura 13 - Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për këtë koncept dokument

Procesi i konsultimit ka synuar:						
- Marrjen e opinionit nga palët e interesuara lidhur me politikën e re në aspekt të përgjithshëm, si dhe me masat specifike dhe elementet tjera të saj në veçanti (për më shumë shihni Kapitullin 3 të këtij Dokumenti – Opsionet).						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara	KGJK, ZKM, MFPT, OSHC, ekspertët vendor dhe ndërkombëtar	Takimi publik	E-mail	26 Korrik 2022		Kryesuesja e grupit punues



Konsultimi i institucioneve relevante	KGJK	Takime/intervista me gjyqtarët, përveç atyre që ishin në përbërje të grupit punues	E-mail/thirrje telefonike	Shtator – Dhjetor 2022		Kryesuesja e grupit punues
Konsultimi i palëve të jashtme të interesuara	Ekspertët nga OECD/SIGMA	Takime online	E-mail	2022 - 2023		Kryesuesja e grupit punues
Konsultimi paraprak me shkrim	Institucionet e Republikës së Kosovës	Shpërndarja e draftit për konsultim paraprak	E-mail	Prill 2023		Kryesuesja e grupit punues
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik dhe konsultimi me shkrim	Platforma dhe e-mail	Maj 2023		Kryesuesja e grupit punues
Konsultim publik	Palët që kanë dërguar komente në Ministri të Drejtësisë	Takim i veçantë	E-mail	Korrik 2023		Kryesuesja e grupit punues

Komentet e pranuar gjatë fazës së konsultimeve nga SKQ, Zyra e BE-së në Kosovë, OSBE, USAID – Programi për Drejtësi Komeriale, IKD, janë trajtuar një nga një dhe qëndrimet e grupit punues lidhur me to janë paraqitur në Raportin e Konsultimit Publik që është publikuar në platformën online të konsultimeve publike.

Politika e re e paraqitur në këtë Koncept Dokument, përkatësisht themelimi i Gjykatës Administrative do të komunikohet përmes masave që do të ndërmerren Ministria e Drejtësisë me KGJK-në, për të informuar qytetarët dhe shoqëritë tregtare mbi rëndësinë dhe kompetencat e kësaj Gjykate.

## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Në kuadër të këtij Koncept Dokumenti janë shqyrtuar tre opsione: 1) Opsioni asnjë ndryshim; 2) Opsioni për fuqizimin e kapaciteteve pa ndryshime organizative, dhe 3) Opsioni për ndryshime organizative ligjore. Si pjesë e Opsionit 3, janë shqyrtuar disa nën-opsione, specifikiisht dy nën-opsione sa i përket juridiksionit për kontestet administrative dhe tre nën-opsione sa i përket juridiksionit për kontestet e punës.

Në vijim do të paraqiten planet e zbatimit për të tre opsionet, duke përfshirë nën-opsionet e përmendura më lartë, si dhe do të bëhet krahasimi i opsioneve për të vlerësuar se cili Opsion/nën-opsion i rekomandohet Qeverisë për miratim.

## Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Opsioni 2 është opsioni për fuqizimin e kapaciteteve pa ndryshime organizative. Këtu parashihen masa për rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës, si dhe programet e specializuara të trajnimit.

Figura 14 - Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i politikës	Themelimi i kornizës institucionale adekuatë për trajtimin e kontesteve administrative dhe të punës						Shifra e kostos së pritur	
	Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative							
Objektivi strategjik	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1 - Zgjidhja e të gjitha konflikteve administrative më të vjetra se dy vite, si dhe zvogëlimi për 50% i kohës në dispozicion sipas indikatorit të CPEJ për 50% në shkallën e parë dhe 30% në shkallën e dytë, deri në vitin 2026.	Produkti 1.1 8 gjyqtarë të rekrutuar në DÇA/GJTHP	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
		x	x				KGJK	
		Aktiviteti 1.1.1 Rekrutimi i 8 gjyqtarëve të rinj		x				KGJK
		Aktiviteti 1.1.2 Trajnimi fillestar i gjyqtarëve të rinj		x	x			AD
		Aktiviteti 1.1.3 Transferimi i tre gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit / DÇA		x				KGJK
		Aktiviteti 1.1.3 Caktimi i gjyqtarëve të rinj në DÇA/GJTHP			x			KGJK/Kryetari i GJTHP
		Produkti 1.2 5 programe të specializuara të	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës
		x						AD
		Aktiviteti 1.2.1						

	Hartimi dhe miratimi i 5 programeve të specializuara për konfliktet administrative									
	Aktiviteti 1.2.2. Mbatja e trajnimeve për gjyqtarët aktual dhe të rinj	x		x		x		x		AD

Opsioni 3 parasheh ndryshime organizative ligjore, ndërsa në kuadër të tij janë dy nën-opsione për kontestet administrative: 3.1. zgjerimi i jurisdiksonit të Gjykatës Komerciale për të gjitha kontestet administrative dhe 3.2. krijimi i Gjykatës së veçantë Administrative, si dhe tre nën-opsione për kontestet e punës: 3.3. krijimi i divizioneve të veçanta për kontestet e punës; 3.2. vazhdimi i divizioneve aktuale civile me jurisdikson vetëm për kontestet nga sektori privat, dhe 3.3. krijimi i Gjykatës së Punës.

Figura 15 - Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Themelimi i kornizës institucionale adekuate për trajtimin e kontesteve administrative dhe të punës						Shifra e kostos së pritur
	Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative						
Objektivi strategjik	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës						
Objektivi Specifik 1 - Zgjidhja e të gjitha konfliktëve administrative më të vjetra se dy vite, si dhe zvogëlimi për 50% i kohës në dispozicion sipas indikatorit të CEPJ për 50% në shkallën e parë dhe 30% në shkallën e dytë, deri në vitin 2026.	Produkti 1.1. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjatësi Komeriale / Ligji i ri për Gjatësi Administrative						
		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës
	Aktiviteti 1.1.1. Hartimi i Ligjit	x					MD
	Aktiviteti 1.1.2. Miratimi i Ligjit	x					Qeveria













## Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Ky nën-kapitull paraqet analizën krahasuese në mes të tre opsioneve, dhe nën-opsioneve në kuadër të Opsionit 3, të trajtuara në këtë Koncept Dokument. Së pari, duhet theksuar se gjendja aktuale me kontestet administrative dhe kontestet e punës nuk është e mirë, ku Kosova qëndron mbrapa sa i përket kohës në dispozicion për zgjidhjen e këtyre rasteve në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor. Pra, procedurat gjyqësore janë duke zgjatur shumë dhe kjo ndikon në qasjen në drejtësi dhe besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor në përgjithësi. Së dyti, duhet të përmendet fakti se vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet evropiane kryesisht kanë tendencë të krijimit të gjykatave të specializuara. Një numër i madh i tyre kanë krijuar tanimë gjykata të veçanta administrative, ku trajtohen të gjitha konfliktet administrative.<sup>94</sup>

Sa i përket efikasitetit, vlen të theksohet se Opsioni 3 që parasheh themelimin e gjykatave/njësive siguron më shumë efikasitet se sa dy opsionet e para. Për shembull, në raport me Opsionin 2 që parasheh rritjen e numrit të gjyqtarëve për kontestet administrative dhe caktimin e gjyqtarëve për kontestet e punës, themelimi i gjykatave të veçanta apo divizioneve të veçanta nënkupton se ato përcjellën edhe me shërbime të veçanta mbështetëse, prioritizim më të madh në ndarjen e resurseve nga KGJK në kuptim më afatgjatë, faktorë të cilat medoemos ndikojnë në rritjen e efikasitetit. Në kuadër të nën-opsioneve të Opsionit 3, vlerësohet se vendosja e kompetencës së Gjykatës Administrative për të gjitha konfliktet administrative pavarësisht natyrës së palës që inicon atë (person fizik, apo shoqëri tregtare) mundëson specializim të gjyqtarëve për konflikte administrative dhe unifikim të praktikës gjyqësore. Gjithashtu, ekzistimi i dy gjykatave të veçanta të specializuara, Gjykatës Komerciale në njërin anë që do të trajtojë kontestet dhe çështjet tjera në mes shoqërive tregtare dhe Gjykatës Administrative në anën tjetër që do të trajtojë të gjitha konfliktet administrative do të mundësojë efikasitet dhe kështu adreson problemin kryesor të paraqitur në këtë Koncept Dokument. Meqë në kuadër të katër nga pesë nën-opsionet e Opsionit 3 parashihet që kontestet e punës nga sektori publik të barten në gjykatë administrative (qoftë si zgjerim i juridiksionit të Gjykatës Komerciale apo Gjykatës së veçantë administrative), kjo zgjedhje duket të jetë më e mirë në raport me krijimin e një Gjykate të veçantë të punës. Kontestet e punës tash për tash nuk janë të një numri aq të madh, veçanërisht ato të sektorit privat, përjashtuar lëndët nga kontratat kolektive të sektorit publik, që janë të përkohshme, aktualisht nuk krijojnë nevojën për një gjykatë të specializuar të Punës në këtë stad. Një Gjykatë e veçantë e punës ka kosto shumë më të madhe se sa nën-opsionet tjera më pak të kushtueshme që janë trajtuar në kuadër të Opsionit 3 (bartja e kontesteve të punës të sektorit publik në gjykatën administrative dhe caktimi i gjyqtarëve të veçantë për kontestet e punës apo themelimi i divizioneve të veçanta për kontestet e punës).

Ka mundësi për fragmentim të praktikës gjyqësore tek kontestet e punës, ngase gjyqtarët në kuadër të gjykatës administrative, kur trajtojnë kontestet e punës të sektorit publik, do të trajtojnë ato në bazë të dy regjimeve juridike (Ligjit për Zyrtarë Publik për një kategori dhe Ligjit të Punës për kategoritë tjera), ndërsa Ligji i Punës do të vazhdonte të ishte regjimi kryesor ligjor për kontestet e punës të sektorit privat, në kuadër të gjykatave civile.

<sup>94</sup> Shih analizën krahasuese në nën-kapitullin 1.8, por edhe 'Administrative Courts in Europe: Common Trends and Requirements' G. Della Cananea. 2018, i qasshëm në: <https://eplopublications.eu/publication/digital-edition/administrative-courts-europe-common-trends-and-requirements>

Sa i përket qasjes në drejtësi dhe besimit të publikut, Opsioni 3 definitivisht ka përparësi ndaj Opsionit 1 dhe 2, madje edhe në kudër të Opsionit 3, vlerësohet se gjykatat e veçanta apo më të specializuara kanë ndikim edhe më pozitiv në këtë aspekt. Me rritjen e besimit të publikut por edhe sigurim të efikasitetit, publiku do t'i drejtohej më shumë gjykatës e kjo nënkupton edhe numër më të madh të rasteve të reja, që tutje validon krijimin e gjykatave të reja, apo të paktën njërive më të veçanta me juridiksion ekskluziv për kontestet e caktuara në kuadër të gjykatave/departamenteve të përgjithshme. Në rritjen e numrit të rasteve të reja në kontestet administrative, siç është cekur më lartë në këtë Koncept Dokument, ndikim do të ketë veçanërisht edhe Projektligji për Konfliktet Administrative, me zgjerimin e gamës së padive që mund të ushtrohen ndaj organeve publike, por edhe eliminimit të rregullit aktualisht të zbatueshëm që shpenzimet gjyqësore në konfliktet administrative ndahen në mes të palëve (Projektligji i ri parasheh që pala humbëse mbulon shpenzimet).

Përfundimisht, sa i përket koston së opsioneve, vlen të theksohet se krijimi i gjykatave të veçanta si Gjykata Administrative e veçantë dhe Gjykata e Punës, kanë koston më të madhe se nën-opsionet tjera në kuadër të Opsionit 3, dhe kërkojnë më shumë kohë për operacionalizimin e tyre në raport me zgjedhjet tjera të konsideruara.

Gjithsesi, kosto është vetëm njëri aspekt dhe çdo shpenzim në këtë drejtim duhet të vlerësohet në raport me efektet që do të arrihen në të ardhmen, ngase kosto mund të duket e madhe në fillim, por në krahasim me reduktimin e shpenzimeve nga buxheti që mund të sjellët përmes efektit që prodhojnë opsionet më të kushtueshme në kuptim afatgjatë, ajo në këtë drejtim do të jetë më e vogël të paktën krahasuar me opsionet fillimisht më pak të kushtueshme ndërsa me shumë shpenzime indirekte afatgjate. Me fjalë të tjera, një gjykatë efikase eliminon shpenzime të panevojshme gjyqësore që mund të paguhen nga administrata ose palët, pastaj kamatat për vonesat gjyqësore do të jenë më të vogla dhe rrjedhimisht mund të eliminohen edhe shpenzimet e procedurave përmbartimore.

Figura 16 - Krahasimi i opsioneve

Metoda e krahasimit: Analiza e kosto-efektivitetit							
Opsionet	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Fuqizimi i kapaciteteve pa ndryshime organizative	Opsioni 3 për ndryshime organizative ligjore				
			3.1. Gjykata Komeriale dhe Administrative	3.2. Gjykata e veçantë Administrative, që trajton të gjitha konfliktet administrative	3.3. Divizionet e veçanta për kontestet e punës	3.4. Divizionet aktuale trajtojnë kontestet e punës nga sektori privat	3.5. Gjykata e Punës
Efikasiteti i gjykatës	---	+	+	++	+	-	+
Unifikimi i praktikës gjyqësore	-	-	++	-	+	--	++

Mundësitë për specializim	---	+	+	++	+	-	--
Prioritizim i drejtësisë administrative / kontesteve të punës	---	--	-	++	+	+	++
Qasja në drejtësi	--	--	+	++	+	+	++
Besimi i publikut	---	--	+	++	+	-	++
Kostot relevante							
	+++	++	+	-	+	++	--
Përfundimi	-----	---	+++++	+++++	+++++	-	+++++
	nuk rekomandohet	nuk rekomandohet	nuk rekomandohet	rekomandohet	rekomandohet	nuk rekomandohet	nuk rekomandohet

## Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Bazuar në të gjitha analizat e bëra në këtë Koncept Dokument dhe veçanërisht krahasimin e opsioneve, rezulton se Opsioni i rekomanduar është Opsioni 3, gjegjësisht nën-opsionet për themelimin e Gjykatës së veçantë Administrative (me juridiksion në të gjitha konfliktet administrative) dhe ai për themelimin e divizioneve të veçanta për kontestet e punës në kuadër të gjykatave themelore që do të trajtojnë vetëm kontestet e punës me sektorin privat si punëdhënës, ngase kontestet e punës me sektorin publik si punëdhënës do të barten në juridiksionin e Gjykatës së re Administrative të themeluar.

Ky Opsion, gjegjësisht këto nën-opsione, përcjellur edhe me masat tjera të veçanta të përcaktuara në Opsionin 3, vlerësohet se do të ndikojnë më së shumti në eliminimin e shkaqeve dhe problemit kryesor të identifikuar në Kapitullin 1 e rrjedhimisht prodhimin e efekteve pozitive për palët, shoqërinë dhe ekonominë e Kosovës në përgjithësi.

Figura 17 - Plani i zbatimit të opsionit të preferuar

Qëllimi i politikës	Themelimi i kornizës institucionale adekuate për trajtimin e kontesteve administrative dhe të punës						Shifra e kostos së pritur
	Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative						
Objektivi strategjik	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës						
Objektivi Specifik 1 - Zgjidhja e të gjitha konfliktëve administrative më të vjetra se dy vite, si dhe zvogëlimi për 50% i kohës në dispozicion sipas indikatorit të CEPEJ për 50% në shkallën e parë dhe 30% në shkallën e dytë, deri në vitin 2026.	Produkti 1.1. Ligji i ri për Gjykatën Administrative						
		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës
		x					MD
	Aktiviteti 1.1.1. Hartimi i Ligjit						Qeveria
	Aktiviteti 1.1.2. Miratimi i Ligjit	x					











### Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Riorganizimi gjyqësor për konfliktet administrative dhe kontestet e punës do të jetësohet gjatë vitit 2024. Ky riorganizim, qoftë nga aspekti ligjor por edhe praktik, do të udhëheqet nga MD dhe KGJK për të siguruar realizimin me kohë dhe ndër marr intervenimet e duhura lidhur me çështjet që mund të shfaqen si pengesë gjatë procesit. Marr parasysh masat tjera që duhet të vijnë pas këtij riorganizimi, vlerësohet se duhet të kalojnë së paku 5 vite, pra rreth vitit 2030, për të vlerësuar efektin real të këtij riorganizimi. Andaj, në atë vit, parashihet të bëhet një vlerësim *ex-post* i kësaj politike.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës <sup>95</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X		I lartë/i ulët	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
Bëria e biznesit	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllën?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		X			
Ngarkesa administrative	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		X			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X			

<sup>95</sup> Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?				x		
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?				x		
Investimet	A pritjet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?				x		
	A pritjet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?				x		
	A do të rriten investimet nga diaspora?				x		
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?				x		
	A do të rriten investimet e huaja direkte?				x		
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?				x		
	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?				x		
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?				x		
Konkurrueshmëria	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?				x		
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?				x		
	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?				x		
	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?				x		
Ndikimi në NVM	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?				x		
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?				x		
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?				x		
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?				x		

	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?				X		
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?				X		
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?				X		
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?				X		
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?				X		

## Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës <sup>96</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x	I lartë/i ulët		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		x			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	x		L	L	L
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X			
	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		x			
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		x			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		x			

<sup>96</sup> Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?				X		
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?				X		
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?				X		
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?				X		
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?				X		
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?				X		
Kultura	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?				X		
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?				X		
	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?				X		
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?				X		
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?				X		
Qeverisja	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?				X		
	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?				X		
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	X					
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X				L	L
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?				X		
	A do të ketë ndikim në shoqërinë civile?				X		





Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		x			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		x			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		x			
Cilësia e ajrit	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		x			
	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		x			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëtokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		x			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		x			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			

	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?				X		
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?				X		
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?				X		
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?				X		
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?				X		
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?				X		
	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?				X		
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?				X		
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?				X		
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?				X		
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?				X		
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?				X		
	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?				X		
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?				X		

	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x		
--	--	--	---	--	--

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		X		I lartë/i ulët	
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		X			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		X			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		X			
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?		X			
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?		X			
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		X			
	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		X			

